



Strategjia
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë
dhe Plani i saj i Veprimit
2021-2023

Mars 2021

Përmbajtja

<u>Lista e shkurtimeve të përdorura</u>	3
<u>1. HYRJE</u>	4
<u>2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</u>	5
<u>3. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË</u>	6
<u>4. VIZIONI, MISIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE DHE PARIMET E GJYKIMIT KUSHTETUES</u>	8
<u>5. HISTORIKU DHE KUADRI LIGJOR</u>	9
<u>6. VËSHTRIM PËR PAVARËSINË DHE PAANËSINË E GJYKATËS</u>	12
<i><u>6.1. Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese</u></i>	14
<i><u>6.2. Financimi i Gjykatës Kushtetuese</u></i>	15
<i><u>6.3. Faktorët e tjerë</u></i>	17
<u>7. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SWOT</u>	18
<u>8. EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I PUNËS SË GJYKATËS</u>	20
<u>9. KOMUNIKIMI, INFORMIMI, TRANSPARENCA DHE BASHKËPUNIMI I GJYKATËS</u>	30
<u>10. BURIMET NJERËZORE DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE</u>	38
<u>11. MENAXHIMI I FINANCIVE PUBLIKE DHE SIGURIMI I KUSHTEVE TË PUNËS TË GJYKATËS</u>	47
<u>12. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË SË GJYKATËS KUSHTETUESE</u>	49
<u>13. NDIKIMI FINANCIAR I STRATEGJISË</u>	50
<u>SHTOJCA 1. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË</u>	54

Lista e shkurtimeve të përdorura

ACCF	Shoqata e Gjykatave Kushtetuese Frankofone (Association des Cours Constitutionnelles Francophones)
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (Consultative Council of European Judges)
CEPEJ	Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë (European Commission for the efficiency of justice)
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KAS	Konrad Adenauer Stiftung
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SWOT	Përparësitë (Strengths), Dobësitë (Weakness), Mundësitë (Opportunities), Rreziqet (Threats)

1. HYRJE

Që prej krijimit në vitin 1992, Gjykata Kushtetuese, gjatë ushtrimit të funksionit të saj, si interpretuesja përfundimtare e Kushtetutës, në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e balancës mes pushteteve, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre, në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të gjitha këto, në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës, si dhe vlerave e parimeve që i parashikon në mënyrë të shprehur Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.¹

Me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016 u bë më evident roli i Gjykatës si garante e të drejtave dhe lirive kushtetuese të individëve. Në lidhje me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, këto ndryshime sollën zgjerimin e ankimit kushtetues individual, i cili tashmë përfshin të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese, si dhe u shtua kompetenca për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjeve që rishikojnë Kushtetutën, vetëm në drejtim të respektimit të procedurës. Po ashtu, ato sollën disa ndryshime në subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si edhe në formulën e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues.

Ndryshimet kushtetuese kanë gjetur reflektim në dispozitat e ligjit organik të Gjykatës, i cili është plotësuar e ndryshuar, duke zberthyer më tej normat kushtetuese.

Si pasojë e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese që parashikojnë rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku u përfshinë edhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, që prej datës 16 korrik 2018 Gjykata u gjend para situatës së mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për funksionimin e saj, e cila vazhdoi deri në përfundimin e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të rinj kushtetues nga organet e emërtesës.

Edhe pse përbërja e Gjykatës Kushtetuese është pothuajse tërësisht e re, ajo synon të ruajë qëndrueshmërinë e jurisprudencës 29-vjeçare të saj, si dhe ta elaborojë atë nën dritën e ndryshimeve kushtetuese. Për këtë qëllim, Gjykata u angazhua seriozisht gjatë vitit 2020 për një planifikim strategjik efektiv afatmesëm dhe afatgjatë të veprimtarisë së saj.

Përmes kësaj Strategjie Gjykata Kushtetuese synon të sigurojë një funksionim të pavarur dhe të paanshëm, transparent dhe llogaridhënës, efikas dhe efektiv. Objektivat e vendosur prej saj synohet të arrihen, mes të tjerash, përmes përmirësimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore për një menaxhim dhe shqyrtim cilësor e efikas të çështjeve. Përballja dhe funksionimi në hap me kohën, në kontekstin e zhvillimeve të reja teknologjike, imponojnë edhe përdorimin e teknologjisë informative dhe zhvillimin e kapaciteteve për përdorimin e saj. Gjykata, gjithashtu, do të ndërmarrë hapa për akses ndaj publikut, duke shtuar informimin dhe komunikimin e palëve të interesuara, si dhe duke zgjeruar komunikimin me mediat. Përmirësimi i këtyre faktorëve do të kontribuojë, ndër të tjera, edhe në pavarësinë, paanshmërinë dhe funksionimin më të mirë të Gjykatës, për pasojë edhe në rritjen e

¹ Fjala përshëndetëse e Kryetares së Gjykatës Kushtetuese në tryezën e organizuar “Për hartimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë 2020 – 2023”, Korçë, 20 shkurt 2020.

besimit te qytetarët. Strategjia përbën instrumentin kuadër të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të veprimtarisë së Gjykatës për periudhën e ardhshme afatshkurtër dhe afatmesme. Me këtë Strategji Gjykata planifikon aktivitetet dhe masat konkrete, të cilat do të ndikojnë në tejkalimin me sukses të sfidave të periudhës së ringritjes dhe, më tej, të zhvillimit të saj.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia për Gjykatën Kushtetuese mbulon periudhën kohore 2021-2023. Ajo përfshin objektiva strategjike dhe objektiva specifike në funksion të përmbushjes së vizionit të Gjykatës. Nga ana metodologjike, progresi i arritjes së objektivave do të matet përmes treguesve të suksesit (*indicators*), të përcaktuar në nivel objektivash specifike dhe përmbushjes së aktiviteteve që janë të përfshira në planin trevjeçar të veprimit, i cili paraqitet si pjesë integrale e Strategjisë.

Strategjia përbëhet nga pjesa hyrëse, e cila shpjegon qëllimin e hartimit të saj. Më pas trajtohet përmbledhja ekzekutive, metodologjia e hartimit të saj, vizioni, misioni, si dhe parimet e gjykimit kushtetues. Dokumenti përmban edhe një përmbledhje të historikut dhe bazës ligjore, si dhe një vështrim për pavarësinë, paanshmërinë dhe funksionimin e Gjykatës, përfshirë sfidat me të cilat ajo përballlet aktualisht apo që mund të përballlet potencialisht në të ardhmen.

Pjesa kryesore e Strategjisë përbëhet nga objektivat strategjike dhe specifike për secilën fushë ku Gjykata ka vendosur të ndër marrë hapa për përmirësim ose zgjerim. Për secilën fushë ofrohet një analizë e gjendjes dhe sfidave të identifikuar, si dhe alternativave për zgjidhje që Gjykata përcakton për të arritur objektivat e synuar. Objektivat strategjike dhe ato specifike të strategjisë paraqiten të përmbledhur si vijon:

Objektivat strategjike	Objektivat specifike
Objektivi strategjik 1 Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv	1.1. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve
	1.2. Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre
	1.3. Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese
	1.4. Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar
Objektivi strategjik 2 Forcimi i besimit te Gjykata përmes komunikimit dhe	2.1. Rritja e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut
	2.2. Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimtarisë së Gjykatës	2.3. Forcimi i komunikimit me medien
Objektivi strategjik 3 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese	3.1. Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj
	3.2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës
	3.3. Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësive të Gjykatës
Objektivi strategjik 4 Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës	4.1. Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës
	4.2. Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës
	4.3. Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën
	4.4. Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Pjesa e fundit e Strategjisë përbëhet nga përshkrimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të Strategjisë, si dhe një përmbledhje e vlerësimit të kostos financiare dhe burimeve të financimit.

Strategjia do të përmbajë, po ashtu, planin e veprimit, si pjesë përbërëse të saj, që përfshin aktivitetet, afatet kohore, përgjegjësinë e zbatimit për secilin aktivitet, koston dhe produktin i cili rezulton nga zbatimi i tij.

3. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për Gjykatën Kushtetuese për vitet 2021-2023 është hartuar në bazë të një analize të rrethanave dhe kushteve në të cilat e ushtron veprimtarinë, duke marrë në konsideratë sukseset e arritura, sfidat me të cilat përballet Gjykata Kushtetuese, si edhe zhvillimet e pritshme gjatë periudhës së zbatimit. Procesi i hartimit të Strategjisë është drejtuar nga Gjykata Kushtetuese përmes Grupit të Planifikimit Strategjik, të përbërë nga përfaqësues të të gjitha njësive organizative të Gjykatës. Gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe drejtuesit e drejtorive të administratës kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm për pasurimin e këtij dokumenti nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në tryeza pune, intervistave të drejtpërdrejta ose dorëzimit të materialeve me shkrim. Për hartimin e Strategjisë kanë ndihmuar ekspertët ndërkombëtarë Ruzhdi Halili, Ph.D., Shefqet

Berisha dhe Jeton Bytyqi, me mbështetjen financiare, organizative dhe logjistike të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Fondacionit KAS, Zyra për Shqipërinë.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar përmes këtyre fazave:

- Faza përgatitore dhe planifikimi i hartimit të Strategjisë.
- Mbledhja e të dhënave, informacioneve dhe analiza fillestare e situatës.
- Diskutime në tryeza të posaçme pune me Gjykatën për hartimin e objektivave dhe veprimtarive.
- Hartimi i Strategjisë dhe i Planit të Veprimit.
- Vlerësimi i kostos së zbatimit.

Faza përgatitore dhe planifikimi i hartimit të Strategjisë – Me urdhrin nr. 9, datë 09.04.2019, Gjykata ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik për hartimin e Strategjisë, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të saj, si dhe rishikimin pas periudhës së caktuar kohore. Grupi i punës së bashku me përfaqësuesit e Zyrës së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe ekspertin ndërkombëtar zhvilluan takimin e parë me temë “Hapat konkretë për hartimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2023” në datën 20 shkurt 2020, në qytetin e Korçës, ku u diskutuan edhe qasja e planifikimi i aktiviteteve për hartimin e Strategjisë.

Mbledhja e të dhënave, informacioneve dhe analiza e situatës – Analiza e situatës ka një rëndësi të veçantë në përgatitjen e një dokumenti strategjik si ai i Gjykatës, analizë nga e cila varet edhe vetë suksesi i zbatimit. Duke marrë këtë fakt në konsideratë, gjatë kësaj faze ekspertët punuan për identifikimin e arritjeve dhe të sukseseve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të sfidave e problemeve që duheshin trajtuar. Analiza e situatës u bazua në dokumente të vëna në dispozicion nga Gjykata Kushtetuese. U morën në shqyrtim materiale të publikuara në faqen zyrtare të saj, por edhe materiale të përgatitura, për këtë qëllim, nga gjyqtarët, këshilltarët ligjorë dhe drejtoritë përkatëse, dhe në datat 8-11 qershor 2020 u zhvilluan takime me përfaqësues të Gjykatës. Gjithashtu, u realizuan edhe videokonferenca përgatitore mes përfaqësuesve të Gjykatës Kushtetuese, OSBE-së, KAS-it dhe ekspertëve.

Hartimi i Strategjisë dhe planit të zbatimit u bë në bazë të të dhënave të mbledhura që kontribuan në përgatitjen e analizës SWOT, si dhe analizës së problemeve nëpërmjet Pemës së Problemeve dhe Pemës së Objektivave, të cilat u bënë pjesë e diskutimeve gjatë tryezave të mbajtura për hartimin e Strategjisë në muajt korrik dhe tetor 2020 me përfaqësuesit e Gjykatës, të OSBE-së e KAS-it, si dhe ekspertët ndërkombëtarë. Përveç kësaj, gjatë procesit të hartimit janë analizuar dhe përdorur dokumente nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, udhëzues të organizmave të tjera të Këshillit të Evropës e në veçanti të CEPEJ-it, Komisionit të Venecias, BE-së, si edhe praktikat e mira të gjykatave simotra evropiane dhe të rajonit, por edhe studime e botime të tjera për drejtësinë kushtetuese.

4. VIZIONI, MISIONI I GJYKATËS KUSHTETUESE DHE PARIMET E GJYKIMIT KUSHTETUES

Vizioni

Gjykata Kushtetuese jep drejtësi kushtetuese, me integritet dhe besueshmëri të lartë nga publiku, duke garantuar respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive të tij, si dhe shtetit të së drejtës.

Misioni

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është të garantojë epërsinë e Kushtetutës dhe forcimin e demokracisë në vend nëpërmjet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimit përfundimtar të Kushtetutës.

Parimet

Parimet e gjykimit kushtetues, siç janë përshkruar në vijim, parashikohen në Kushtetutë² dhe në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000)³, si dhe në vendimet e kësaj Gjykate në të cilat interpretohen këto norma.

Pavarësia - Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.⁴

Shqyrtimi kolegjal

Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjisht dhe vendimi merret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.⁵

Procesi publik

Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve vendos nëse çështjet shqyrtohen në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve. Seanca plenare ose një pjesë e saj mund të zhvillohet pa praninë e publikut, kur kjo diktohet për arsye të mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të të drejtave vetjake.⁶

Përdorimi i gjuhës shqipe

Gjykimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe kur është e nevojshme Gjykata siguron përkthimin në gjuhën shqipe.⁷

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (e përditësuar). Shih: <https://qgz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd>

³ Shih:

http://www.gjk.gov.al/web/ligj_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_kushtetuese_2016_1667.pdf

⁴ Neni 124, pika 2, i Kushtetutës; neni 3 i ligjit nr. 8577/2000.

⁵ Neni 20 i ligjit nr. 8577/2000.

⁶ Neni 21 i ligjit nr. 8577/2000.

⁷ Neni 22 i ligjit nr. 8577/2000.

Mbrojtja në gjykimin kushtetues

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.⁸

Paanshmëria në gjykimin kushtetues

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet vetëm në Kushtetutë dhe në ligj. Ai merr pjesë në gjykim vetëm në cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social.⁹

Fuqia detyruese e vendimit dhe transparenca

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj të fillojë efektet në një datë tjetër.¹⁰ Kur vendimi sjell pasoja për të drejtat kushtetuese të individit, Gjykata mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi ditën e shpalljes së tij.¹¹

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen në Fletoren Zyrtare, si dhe në mjete të tjera të informimit publik.¹²

Efikasiteti dhe efektiviteti - Gjykata kujdeset për shpejtësinë dhe cilësinë e vendimmarrjes së saj.

Integriteti - Gjyqtarët dhe stafi administrativ duhet të tregojnë standardet më të larta të integritetit, duke iu përmbajtur parimeve morale dhe etike. Kjo duhet të manifestohet në sjellje të përgjegjshme dhe llogaridhënëse.

5. HISTORIKU DHE KUADRI LIGJOR

Ndryshimet demokratike që ndodhën në fillim të viteve '90-të shënuan kthesë rrënjësore në historinë e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij. Orientimi demokratik i shtetit kërkonte kryerjen e një reforme institucionale të thellë, e cila duhet t'u hapte rrugë ndryshimeve demokratike për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në kuadër të këtyre ndryshimeve u krijua edhe Gjykata Kushtetuese, si një nga institucionet më të rëndësishme për garantimin e rendit të ri kushtetues që po instalohet në Shqipëri.¹³ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë është krijuar me ligjin kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Nenet 17 deri 28 të këtij ligji parashikuan krijimin e Gjykatës Kushtetuese,

⁸ Neni 24 ligjit nr. 8577/2000.

⁹ Neni 25 i ligjit nr. 8577/2000.

¹⁰ Neni 132 i Kushtetutës.

¹¹ Neni 26, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000.

¹² Neni 26, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

¹³ Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese. Shih: http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php

përcaktuan statusin e saj, përbërjen, kompetencat, strukturën dhe mënyrën e funksionimit. Po kështu, ligji formuloi edhe parimet që duheshin ndjekur për të ushtruar kontrollin kushtetues.

Pesë anëtarët e parë të Gjykatës u zgjodhën me vendimin e datës 06.05.1992 të Kuvendit, kurse katër anëtarët e tjerë me dekretin e Presidentit të datës 18.05.1992. Gjykata filloi veprimtarinë e saj në datën 19.05.1992, pas ceremonisë së betimit para Presidentit të Republikës, kurse seanca e parë gjyqësore dhe vendimi i parë i kësaj Gjykate mbajnë datën 13.07.1992.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila hyri në fuqi më 28 nëntor 1998, Gjykata Kushtetuese fitoi një pozitë të rëndësishme institucionale. Nenet 124 deri 134 të Kushtetutës i kushtohen Gjykatës Kushtetuese si juridiksion kushtetues i pavarur. Këto dispozita përcaktojnë përbërjen, emërimin dhe statusin e gjyqtarëve, kompetencat e saj, subjektet që mund ta vënë në lëvizje, forcën detyruese dhe zbatimin e vendimeve të saj. Sipas nenit 124, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës e i nënshtrohet vetëm kësaj të fundit.

Kushtetuta kërkonte nxjerrjen e akteve ligjore për zbatimin e saj. Si rrjedhojë, Kuvendi miratoi ligjin nr. 8577/2000, i cili rregullon, mes të tjerash, statusin dhe mandatin e gjyqtarit, mënyrën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin paraprak, procedurat e gjykimit, efektet e vendimit, etj.¹⁴

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 prekën edhe aspekte të organizimit, funksionimit dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, të cilat u reflektuan edhe në ligjin e saj organik. Konkretisht, u ndryshua formula e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (më në detaje shih seksionin 6.1.), u shtuan disa kompetenca, si dhe u ridimensionuan në funksion të efikasitetit dhe efektivitetit disa kompetenca të tjera.

Një ndër aspektet e rëndësishme të kompetencave të ridimensionuara, si rezultat i këtyre ndryshimeve kushtetuese, është zgjerimi i ankimit kushtetues individual, i cili i ofron një mbrojtje më të gjerë individit, duke parashikuar të drejtën e tij për t'`u ankuar kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, por pasi të ketë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Po ashtu, Gjykatës i është njohur kompetenca që gjatë shqyrtimit të një ligji që rishikon Kushtetutën, të kontrollojë respektimin e procedurës së miratimit të tij. Më tej, ligji ka parashikuar edhe mundësinë e rihapjes së procesit para Gjykatës kur vendimi i saj është konsideruar në shkelje të detyrimeve të së drejtës ndërkombëtare nga gjykatat ndërkombëtare.

¹⁴ Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese. Shih: http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php

Ndryshimet kushtetuese kanë prekur edhe rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Sipas nenit 134, pika 1, janë shtuar edhe disa subjekte që kanë në thelb të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç janë komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta, si dhe KLGJ-ja dhe KLP-ja, si organe kushtetuese të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.¹⁵

Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese dhe procedurat e brendshme janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Gjykatës, e cila përcakton rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit kushtetues, si dhe ato lidhur me strukturën administrative të kësaj Gjykate.¹⁶ Në kuadrin e ndryshimeve të ligjit organik të Gjykatës lindi nevoja e ndryshimit të Rregullores së Brendshme dhe përshtatjes së saj me dispozitat e reja ligjore, me qëllim reflektimin në të edhe të problematikave të hasura gjatë zbatimit në praktikë të parashikimeve të këtij akti. Për këtë arsye, me urdhrin nr. 284, datë 18.11.2016 të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, u ngrit Grupi i Punës për ndryshimin e Rregullores së Brendshme. Në vitin 2017 ky grup hartoi një projekt rregullore, e cila, për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje në Mbledhjen e Gjyqtarëve, nuk arriti të diskutohej dhe miratohej.

Pas fillimit të punës në Gjykatën Kushtetuese u vlerësua i rëndësishëm dhe nevojë e menjëhershme vijimi i procesit të hartimit të rregullave të brendshme të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të saj. Për këtë qëllim, me vendimin e datës 07.01.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi hartimin e dy rregulloreve të Gjykatës, Rregullores për Procedurat Gjyqësore dhe Rregullores së Brendshme për veprimtarinë e administratës. Me urdhrin nr. 32 prot., datë 14.01.2021 të Kryetares së Gjykatës u ngrit grupi i punës, të cilit iu ngarkua detyra për harmonizimin dhe plotësimin e rregullave procedurale dhe administrative me ato të ligjit organik. Grupi i punës ka paraqitur një projekt të Rregullores për procedurat gjyqësore, i cili është për shqyrtim nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

Kuadri ligjor në fuqi, i cili në mënyrë direkte ose indirekte prek njësi të caktuara, të cilat ndikojnë në veprimtarinë e Gjykatës, përbëhet nga disa ligje. Këtu përfshihen, mes të tjerash, ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”¹⁷, ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”¹⁸ dhe ligji “Për prokurimin publik”¹⁹.

Përmirësimi i legjislationit mbetet proces i vazhdueshëm, edhe pse kuadri ligjor kryesor për funksionimin e Gjykatës tashmë është i plotësuar. Megjithatë duhet thënë se është zbatimi i tij

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Rregullore e Brendshme e Gjykatës Kushtetuese, neni 1. Shih: http://www.gjk.gov.al/web/rregullore_e_brendshme_81.pdf

¹⁷ Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2013/05/30/152-2013/b5d32f00-10b2-4ead-931a-48a7eb62dd1c;q=ligjit%20nr.152%2F2013>

¹⁸ Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/22/114/e12b9d0d-a63d-4efd-be99-d1485ecc667e;q=Ligji%20nr.114%2F2015>

¹⁹ Ligji “Për prokurimin publik”. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2018/12/13/103>

ai që ka rëndësi të veçantë, duke qenë se përbën arsyen e vetë ekzistencës së këtij legjislacioni. Plotësimi i akteve të brendshme nënligjore, të cilat do të sigurojnë funksionimin efikas dhe efektiv të Gjykatës, realizon edhe zbatimin e duhur të parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore.

6. VËSHTRIM PËR PAVARËSINË DHE PAANËSINË E GJYKATËS

Duke pasur në vëmendje se pavarësia e gjyqësorit është një element thelbësor i parimit të shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pavarësia e Gjykatës Kushtetuese merr një rëndësi të shtuar në zbatim të këtyre parimeve themelore dhe të të drejtave kushtetuese.

Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Bazuar në nenin 145, pika 1, të Kushtetutës, pushteti gjyqësor përveç pavarësisë së jashtme (pavarësia nga pushtetet e tjera), ka edhe një pavarësi të brendshme, e cila është po aq e rëndësishme. Pavarësia gjyqësore individuale sigurohet krahas procedurave të emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve mbi bazën e kualifikimit profesional dhe integritetit personal, edhe nëpërmjet kohëzgjatjes së ushtrimit të funksionit e sigurisë financiare, pavarësisë në vendimarrje, si dhe garantimit të të drejtave vetjake.²⁰

Pavarësia e gjyqësorit përfshin elementin objektiv, si një cilësi e domosdoshme e gjyqësorit si i tillë, dhe elementin subjektiv, si e drejta e një individi që të drejtat dhe liritë e tij të shqyrtohen nga një gjyqtar i pavarur. Kjo pavarësi e gjyqësorit nuk është një qëllim në vetvete dhe as një privilegj personal i gjyqtarëve, por justifikohet nga nevoja për t'u mundësuar gjyqtarëve që të përmbushin rolin e tyre si garantë të të drejtave dhe lirive të individëve. Pavarësia e gjyqtarëve dhe, për pasojë, reputacioni i gjyqësorit në një shoqëri të caktuar varet nga shumë faktorë. Përveç rregullave institucionale që garantojnë pavarësinë, rëndësi të madhe ka edhe karakteri personal dhe cilësia profesionale e gjyqtarëve që vendosin për një çështje. Kultura juridike në tërësi është gjithashtu e rëndësishme.²¹

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji organik i Gjykatës Kushtetuese ofrojnë garanci të veçanta, të cilat u mundësojnë gjyqtarëve ruajtjen e pavarësisë gjatë marrjes së vendimeve. Ana e jashtme e pavarësisë së gjyqtarëve rregullohet si më poshtë:

- Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike, shtetërore, si dhe me veprimtari profesionale që ushtrohen kundrejt pagesës, me përjashtim të atyre të mësimdhënies, akademike dhe shkencore sipas ligjit.²²

²⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.04.2017, paragrafët 78-80.

²¹ European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Report on the Independence of the Judicial System Part I: The Independence of Judges, 12-13 March 2010. Shih: <https://rm.coe.int/1680700a63>

²² Neni 130 i Kushtetutës.

- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim.²³
- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj²⁴. Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjisht.²⁵
- Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore për shkaqet e parashikuara në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Shqyrtimi i shkeljes disiplinore kryhet nga Komisioni Disiplinor, i përbërë nga 3 gjyqtarë të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe të provave.
- Gjykata, sipas nenit 124 të Kushtetutës, si dhe ligjit organik të saj, ka buxhet të veçantë dhe pavarësi në administrimin e buxhetit dhe të burimeve njerëzore të saj.
- Ligji organik ka parashikuar edhe disa aspekte të rëndësishme të një organizimi sa më efikas të Gjykatës, siç është zgjedhja e Kryetarit nga vetë gjyqtarët e Gjykatës, duke shmangur ndikimin nga jashtë në çështje të brendshme të organizimit të saj; ngritja e Njesisë së Shërbimit Ligjor, e përbërë nga këshilltarë ligjorë, si strukturë me karakter shkencor dhe e ofrimit të ndihmës në vendimmarrjen e Gjykatës; çështje që lidhen me mënyrën e vendimmarrjes, publicitetin, transparencën, por edhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm; rregullime përkatëse në lidhje me zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

Është e qartë se përtej kornizës kushtetuese dhe ligjore, e cila është parakusht për pavarësinë e Gjykatës dhe funksionimin e saj, mbetet thelbësor zbatimi i saj në praktikë. Kështu, për të ruajtur pavarësinë, Gjykatës i duhet të menaxhojë të gjithë veprimtarinë e saj në mënyrë sa më efektive, duke treguar përgjegjshmëri edhe para publikut. Për ta arritur këtë, Gjykata duhet të kombinojë një leadership efektiv, plane të qarta veprimi, burime të nevojshme për zbatimin e këtyre planeve, matje të saktë të performancës, si dhe të tregojë përgjegjshmëri publike për atë performancë.

Një pjesë e madhe e vështirësive dhe problematikave të hasura më herët në funksionimin e Gjykatës, tashmë janë reflektuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit për organizimin dhe funksionimin e saj të vitit 2016. Ndryshimet ligjore, megjithëse përmirësuan shumë probleme të shfaqura, njëkohësisht e kanë vënë Gjykatën përballë sfidave të reja. Po ashtu, parë edhe në këndvështrimin e detyrimit të shtetit shqiptar, në një të ardhme të afërt, për të vënë në zbatim normat e Bashkimit Evropian, Gjykatës Kushtetuese i imponohet krahas koherencës në vendimmarrje, edhe zhvillimi i mëtejshëm i jurisprudencës së saj, duke reflektuar arritjet më të mira të rendit ligjor evropian.

²³ Neni 126 i Kushtetutës.

²⁴ Neni 25, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

²⁵ Neni 20 i ligjit nr. 8577/2000.

Pavarësia e gjyqësorit, sipas Gjykatës, duhet kuptuar si *pavarësi thelbësore* (tagër i gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit) dhe si *pavarësi strukturore*, që kërkon parashikimin në Kushtetutë të institucionit që realizon emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve. Si pjesë të pavarësisë strukturore kjo gjykatë ka konsideruar njëkohësisht edhe pavarësinë organizative dhe financiare.²⁶ Të njëjtat parime dhe standarde të elaboruara në jurisprudencën kushtetuese, që lidhen me pavarësinë dhe paanshmërinë, gjejnë zbatim edhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kësaj Gjykate. Në këtë drejtim, ndër sfidat kryesore të shfaqura gjatë viteve të fundit janë plotësimi i numrit të gjyqtarëve kushtetues dhe sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm të saj, që ndikojnë në evitimin e shumë vështirësive të tjera, të cilat, gjithashtu, ndikojnë në pavarësinë dhe paanësinë e vendimmarrjes së gjykatës, si dhe në ushtrimin e plotë të funksioneve dhe veprimtarisë së saj me efikasitet dhe në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ato ligjore.

6.1. Emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

Çështja e emërimit të gjyqtarëve kushtetues ka qenë një sfidë, e cila e ka shoqëruar Gjykatën Kushtetuese për një kohë të gjatë. Sistemi i mëparshëm i emërimit të gjyqtarëve, kur pas përzgjedhjes nga Presidenti kandidaturat kalonin në Kuvend për dhënien e pëlqimit, nuk rezultoi i suksesshëm. Problemet e vërejtura për sa i përket eficiencës së Gjykatës lidheshin kryesisht me: a) mungesën e një procesi transparent për mbledhjen dhe seleksionimin e kandidaturave për gjyqtarë në Gjykatë; b) vonesën e tejzgjatur në plotësimin e vendeve vakante të krijuara për shkak të dorëheqjes së gjyqtarit të Gjykatës; c) mungesën e rregullave të qarta, mbi bazën e të cilave të funksionojë procesi i emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës, dhe të kriterëve ligjore që duhet të përmbushin kandidatët që të dëshmojë për objektivitet dhe paanshmëri të vendimmarrësve; ç) paqartësitë ekzistuese për çështje që i përkasin mandatit kushtetues.²⁷

Ndryshimet kushtetuese, të miratuara si pjesë e paketës ligjore të reformës në drejtësi, ndryshuan edhe procedurën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke futur një formulë të ndryshme, sipas së cilës gjyqtarët zgjidhen nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë (secili prej tyre zgjedh 1/3-at e gjyqtarëve).

Por edhe formula e re shfaqti probleme në zbatimin e saj për shkak të problematikave të evidentuara, duke nisur që nga ato që lidhen me veprimtarinë dhe funksionimin e KED-së, ashtu edhe mungesën e kandidaturave për t'iu dërguar organeve të emërtesës. Për pasojë, Gjykata mbeti pa kuorumin e nevojshëm ligjor që nga muaji mars i vitit 2018 deri në muajin nëntor të vitit 2019 kur u emëruan 3 gjyqtarët e rinj (2 nga Kuvendi dhe 1 nga Presidenti). Në fund të vitit 2020, KED-ja përfundoi procedurat e vlerësimit dhe të pikëzimit edhe për 3 kandidatë të tjerë, të cilët u emëruan anëtarë të Gjykatës Kushtetuese në muajin dhjetor të vitit 2020, përkatësisht 2 nga

²⁶ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 05.12.2008.

²⁷ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, qershor 2015, fq. 25.

Presidenti i Republikës dhe 1 nga Kuvendi. Për rrjedhojë, që prej muajit dhjetor 2020, Gjykata ka kuorumin e kërkuar ligjor për funksionimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Ndërkohë që plotësimi i vakancave të tjera, të cilat kanë si organ emërtese Gjykatën e Lartë është një çështje që ka mbetur ende pezull, për shkak të mungesës së kuorunit të nevojshëm ligjor për të emëruar 3 gjyqtarët kushtetues.

Një nga vështirësitë eventuale nga ripërtëritja totale e trupës gjyqësore është sfida për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e jurisprudencës 29-vjeçare të Gjykatës Kushtetuese dhe elaborimin e saj nën dritën e ndryshimeve kushtetuese në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj Gjykate.

6.2. Financimi i Gjykatës Kushtetuese

Koncepti i pavarësisë në administrimin e buxhetit do të thotë që institucioni që administron buxhetin është i lirë, në respekt të ligjit, të përcaktojë ose ripërcaktojë fondet buxhetore midis këtyre kategorive. Përgjegjësia për buxhetin është e lidhur, gjithashtu, edhe me kompetenca administrative që përfshijnë menaxhimin e burimeve njerëzore që kanë efekte financiare (emërim, largim), por edhe kompetencën për të prokuruar mallra ose shërbime, si dhe kompetenca të tjera. Nga ana tjetër, koncepti i pavarësisë financiare dhe i autonomisë buxhetore kërkon që organeve kushtetuese duhet t'u merret mendim kur për arsye të jashtëzakonshme mund të ketë shkurtime ose bllokime të fondeve që janë pjesë e buxhetit të tyre. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se edhe në raste të kësaj natyre, në respekt të standardit kushtetues të *administrimit vetë të buxhetit të tyre*, ndërhyrja e ligjvënësit ose ekzekutivit për të ulur buxhetin gjyqësor, qoftë dhe si një përpjekje për të shmangur deficitin buxhetor, do të konsiderohej e pajustificuar, pa një konsultim me vetë gjyqësorin²⁸. Janë pikërisht aspektet e pavarësisë financiare, të cilat lidhen me konceptet e sipërcituara për *autonominë buxhetore*, ato që nuk lejojnë, nga pikëpamja kushtetuese, ndërhyrjen e pushteteve të tjera në administrimin e buxhetit të gjyqësorit²⁹.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i garanton Gjykatës Kushtetuese pavarësi në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit kur shprehet se *“Gjykata Kushtetuese ka buxhet të veçantë, të cilin e administron në mënyrë të pavarur”*.³⁰ Sipas ligjit organik *“Gjykata Kushtetuese administron buxhetin e saj, i cili, si pjesë e buxhetit të shtetit, hartohet prej saj dhe i paraqitet për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”*.³¹

Në drejtim të pavarësisë financiare, CCJE-ja është shprehur se megjithëse financimi i gjykatave është pjesë e buxhetit të shtetit të paraqitur në Kuvend nga Ministria e Financave, këto fonde nuk duhet të jenë subjekt i luhatjeve politike. Megjithëse niveli i financimit që një vend mund të

²⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 06.04.2010, paragrafi 25.

²⁹ Po aty, paragrafi 26.

³⁰ Neni 124, pika 3, i Kushtetutës.

³¹ Neni 6 i ligjit nr. 8577/2000.

përballojë për gjykatat e tij është një vendim politik, duhet pasur gjithmonë kujdes, në një sistem të bazuar në ndarjen e pushteteve, për të siguruar që ekzekutivi dhe autoritetet legislative të mos jenë në gjendje të ushtrojnë presion mbi gjyqësorin kur vendosin për buxhetin e tij. Vendimet për shpërndarjen e fondeve në gjykata duhet të merren në respektim të parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.³²

Në përputhje me kompetencën e saj të përcaktuar në nenin 124 të Kushtetutës, si dhe në ligjin organik, Gjykata Kushtetuese buxhetin e saj, të konceptuar në plane afatgjata, afatmesme ose vjetore, të cilin e administron në mënyrë të pavarur, duhet ta programojë duke iu përgjigjur nevojave reale të zhvillimit të veprimtarisë së saj. Ndryshimet kushtetuese në lidhje me pavarësinë në administrimin e buxhetit nga ana e Gjykatës Kushtetuese u mirëpritën edhe nga Komisioni i Venecies.³³ Nga ana tjetër, kompetencat që ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor i jep Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për administrimin e buxhetit, nuk paragjykojnë dhe kufizojnë kompetencat e Gjykatës në aspektin e autonomisë buxhetore. Megjithatë, mosmiratimi i buxhetit për Gjykatën Kushtetuese nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit, në shkallën e kërkuar, ka qenë një sfidë, e cila e ka kufizuar Gjykatën si në realizimin e projekteve të saj për modernizimin e sistemeve bashkëkohore të menaxhimit dhe ngritjes së llogaridhënies dhe transparencës, ngritjen e kapaciteteve të saj njerëzore, ashtu edhe në përmirësimin e kushteve të punës për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së saj.

Në figurën nr. 1 tregohet se lakorja e buxhetit të miratuar nga Kuvendi për pesë vjetët e kaluar është në shumicën e rasteve e rrafshët, madje në disa raste (buxheti i vitit 2016 dhe buxheti i vitit 2020) buxheti i miratuar është më i ulët sesa vitet paraprake. Ndërsa dallimi mes nevojave të Gjykatës të parashtruara përmes kërkesave buxhetore ndër vite dhe shkallës së miratimit të buxhetit ose tavaneve buxhetore të vendosura për vitet e ardhshme vazhdon të rritet, sidomos vitet e fundit (shih në figurën nr. 1 vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022). Pasojat ekonomike dhe sociale të shkaktuara nga pandemia COVID-19, të cilat mund të ndikojnë në buxhetin e shtetit, do ta bëjnë edhe më sfiduese përpjekjen e Gjykatës për plotësimin e kërkesave për buxhet në pajtim me nevojat e saj.

³² Consultative Council of European Judges (CCJE), OPINION No 2 (2001), of the Consultative Council of European Judges (CCJE) for the attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Funding and Management of Courts with Reference to the Efficiency of the Judiciary and to Article 6 of the European Convention on Human Rights, paragraph 5. Shih: <https://rm.coe.int/1680747492>

³³ European Commission for Democracy through Law (Venice Commission) Interim Opinion on the Draft Constitutional Amendments on the Judiciary of Albania, 18-19 December 2015, p. 6. Shih: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2015\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2015)045-e)




Figura 1: Buxheti për Gjykatën Kushtetuese 2015-2022. Të dhënat janë nxjerrë nga raportet buxhetore të Gjykatës

Nga ana tjetër, përveç aspekteve të miratimit të buxhetit në masën e kërkuar, pengesa paraqiten edhe për sa i përket zbatimit dhe shpenzimeve për buxhetin e miratuar. Bazuar në sistemin e menaxhimit të financave publike, buxheti përcaktohet duke u ndarë në zëra të caktuar, dhe për çdo ndryshim që Gjykata ka nevojë të bëjë gjatë procesit të zbatimit të tij, kërkohet leje/autorizim nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Kjo fazë e menaxhimit të buxhetit, gjithashtu, lidhet me pavarësinë buxhetore dhe cenon dispozitat përkatëse kushtetuese.

Duke pasur parasysh këto rrethana, Gjykata së bashku me Kuvendin dhe Ministrinë e Financave duhet të gjejnë mekanizmat e përshtatshëm për të zgjidhur problematikën e mungesës së mjeteve të nevojshme financiare për funksionimin e pavarur të saj. Kërkohet aktivizimi i Gjykatës në ndërmarrjen e veprimtarive sensibilizuese përmes bashkëpunimit më të ngushtë me Kuvendin dhe komisionet përkatëse të tij, si dhe organizimi i konferencave dhe diskutimeve me palët kryesore të interesuara. Mjetet e komunikimit duhet të shfrytëzohen në maksimum, sidomos gjatë periudhës vjetore kur zhvillohet procesi i planifikimit dhe vendimmarrja për buxhetin.

6.3. Faktorët e tjerë

Duhet theksuar se përveç sa më sipër, faktorë të tjerë të shumtë, të brendshëm dhe të jashtëm, ndikojnë në pavarësinë dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese. Ndër faktorët që mund të përmendim këtu janë: shkalla e besimit që qytetarët kanë për Gjykatën, shkalla e mundësisë së zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, ndikimi i reformës në drejtësi, debatet politike dhe mediatike për funksionimin dhe pavarësinë e Gjykatës, shkalla e efikasitetit dhe efektivitetit

të Gjykatës, kapacitetet profesionale në shqyrtimin e çështjeve të paraqitura në Gjykatë, sigurimi i koherencës së jurisprudencës së saj për shkak të përbërjes së trupës gjyqësore pothuajse me gjyqtarë të rinj, ekzistenca e kushteve të përshtatshme të punës dhe e mjeteve të nevojshme për kryerjen e detyrave të saj etj. Faktorë të tillë janë pjesë e analizës, objektivave dhe masave në kapitujt e mëposhtëm të Strategjisë.

7. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SWOT

Gjatë planifikimit strategjik është me rëndësi të përdoren edhe mjete, me anën e të cilave identifikohen problemet dhe sfidat, mangësitë, arritjet, përparësitë dhe elemente të tjera. Duke pasur këtë në vëmendje, Grupi i Punës për Strategjinë, së bashku me Kryetaren e Gjykatës, gjyqtarët, stafin e saj dhe ekspertët punuan me mjete si: analiza e Pemës së Problemeve dhe analiza e Pemës së Objektivave. Në tryezën e datave 8 dhe 9 korrik 2020 u hartua edhe analiza SWOT, e cila është një metodë specifike për studimin e mjedisit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Nëpërmjet saj, Gjykata përcakton pikat e forta dhe të dobëta të saj, si dhe mundësitë e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet. Më poshtë paraqitet përmbledhja e analizës SWOT për Gjykatën Kushtetuese. Gjetjet e kësaj analize ndihmojnë edhe në identifikimin e objektivave dhe masave që do të merren për zbatimin e Strategjisë dhe të planit të saj të veprimit.

Pikat e forta (strengths):	Pikat e dobëta (weaknesses):
<ul style="list-style-type: none"> • Pavarësia organizative, administrative e financiare e institucionit. • Tradita e krijuar e gjykimit kushtetues në Shqipëri. • Vendimmarrja dhe jurisprudenca 29-vjeçare e gjykatës. • Përvoja dhe ekspertiza e gjatë dhe e larmishme e gjyqtarëve në fushën e së drejtës. • Përvoja dhe ekspertiza e këshilltarëve ligjorë. • Krijimi i Njësisë së Shërbimit Ligjor. • Gatishmëria dhe përkushtimi i lidershipit të Gjykatës dhe gjyqtarëve për zhvillimin afatgjatë të Gjykatës dhe rritjen e performancës institucionale. • Staf i motivuar për t'u përballur me sfidat e gjykatës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Buxhet i pamjaftueshëm për të garantuar një performancë edhe më eficiente dhe efektive. • Mungesa e një sistemi eficient dhe bashkëkohor kompjuterik të menaxhimit të çështjeve dhe komunikimit të brendshëm (workflow). • Përmirësimi i bashkërendimit në procesin e planifikimit të veprimtarive të gjykatës. • Mungesa e sistemit të integruar dhe bashkëkohor të vlerësimit të performancës, si dhe rishikimi i përshkrimeve të punës. • Nevoja për një sistem efektiv të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe plan të qëndrueshëm e afatgjatë për ngritjen e kapaciteteve. • Mungesa e një rregulloreje për marrëdhënien me publikun dhe median. • Infrastruktura e pamjaftueshme dhe e papërshtatshme për sa i përket godinës, ambienteve të punës, arkivës dhe magazinimit.
Mundësitë (opportunities)	Rreziqet (threats):
<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi periodik i buxhetit. • Mbështetja teknike nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë. • Anëtarësia në organizata ndërkombëtare dhe shkëmbimi i eksperiencave me gjykata simotra në rajon dhe më gjerë. • Besimi i qytetarëve dhe publikut te Gjykata dhe drejtësia kushtetuese. • Ndikimi i procesit të integrimit evropian. 	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, të patestuara në praktikë. • Mundësia e rritjes së numrit të çështjeve dhe ngarkesës së gjykatës. • Mosrespektimi i plotë i pavarësisë së Gjykatës sidomos në sferën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore. • Mosmiratimi i kërkesave për rekrutim të stafit. • Presionet politike dhe mediatike. • Ndryshimet e shpeshta ligjore. • Mungesa e konsultimit të Gjykatës kur vendosen detyra për të në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga proceset e integrimit ose anëtarësimit në organizma ndërkombëtarë.

ANALIZA E ÇËSHTJEVE KRYESORE DHE OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË

8. EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I PUNËS SË GJYKATËS

Objektivi strategjik 1. Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv

Efikasiteti dhe efektiviteti³⁴ i punës së Gjykatës janë të lidhur me shumë faktorë. Çelësi për funksionimin efektiv dhe sigurimin e efikasitetit të punës së Gjykatës është një trupë gjyqtarësh dhe personel profesional e mbështetës, të organizuar dhe trajnuar mirë, të motivuar për kryerjen e detyrave të tyre, të cilët e kuptojnë se janë në shërbim të qytetarëve. Sipas standardeve të Këshillit të Evropës masat që ndërlidhen me eficiencën grupohen në fushat strategjike që lidhen me performancën organizative, qeverisjen dhe strukturën organizative, kapitalin njerëzor, optimizimin e proceseve të brendshme të punës, përdorimin e teknologjisë informative, kontrollin e brendshëm, etj.

Arritja e këtij objekti strategjik realizohet përmes arritjes së objektivave specifike, si në vijim:

Objektivi specifik 1.1.	Objektivi specifik 1.2.	Objektivi specifik 1.3.	Objektivi specifik 1.4.
Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve	Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre	Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese	Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar

Objektivi specifik 1.1. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve

Një nga shqetësimet kryesore për efikasitetin e punës së gjykatave është kohëzgjatja e proceseve gjyqësore: *Si të sigurohet drejtësia në një kohë të përshtatshme?* Kohëzgjatja e tepruar e proceseve gjyqësore është një problem i madh në shumicën e vendeve evropiane. Gjykatat duhet të merren me ngarkesën e çështjeve të tyre brenda një kohe të arsyeshme, siç parashikohet në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. GJEDNJ-ja është shprehur në jurisprudencën e saj për *“rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa, të cilat mund të rrezikojnë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj”* (çështja *H kundër Francës*). Vonesat në administrimin e

³⁴ Efektiviteti mund të përkufizohet si arritje e suksesshme e rezultateve të pritura, ndërsa efikasiteti si shkalla në të cilën koha, përpjekja ose kostoja janë përdorur mirë për detyrën ose qëllimin e synuar. Council of Europe, Long-term budgetary sustainability and efficiency of the Organization. Measures to enhance efficiency and effectiveness. 13 January 2015.

Shih: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805c463b#globalcontainer

drejtësisë rrezikojnë shtetin e së drejtës, standard ky i vendosur nga vetë Gjykata Kushtetuese në vendimmarrjen e saj, si dhe nga organizatat të cilat monitorojnë zbatimin e procesit të rregullt ligjor në vend.³⁵ Duhet thënë se GJEDNJ-ja deri tani nuk ka shprehur në mënyrë të qartë se sa është kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave dhe cila kohëzgjatje në nivele të veçanta të juridiksionit është e arsyeshme dhe si të llogaritet ajo.³⁶ Vonesat në gjykimin e çështjeve, sado të vogla qofshin, pengojnë përdorimin efikas të burimeve administrative dhe financiare që mund të shërbejnë për të gjykuar më shumë çështje. Kur vonesat janë të dukshme, i atribuohen shtetit dhe janë të shmangshme, mund të cenojnë të drejtën e palëve për një gjykim të drejtë, duke përfshirë edhe të drejtën për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm.³⁷

Në lidhje me afatet e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese, neni 47, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar se si rregull shqyrtimi i çështjeve nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve përfundon brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton afate të tjera, duke iu referuar dispozitave të ligjit që rregullojnë procedurat e veçanta të parashikuara në kreun VII të tij, të cilat kanë parashikuar në mënyrë të shprehur disa afate për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata dhe dhënien e vendimit.³⁸ Në pikën 3 të nenit 47 të ligjit është parashikuar, gjithashtu, se vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe prej tij.

Po ashtu, neni 71/ç i ligjit nr. 8577/2000 ka njohur të drejtën e kujtudo që është palë në procesin që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese ose palë në një proces gjyqësor të pezulluar, si rrjedhojë e një kontrolli incidental ose shqyrtimi të kushtetutshmërisë së ligjit të iniciuar nga subjekte të tjera, të parashikuara në nenin 134, të Kushtetutës, dhe pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, të kërkojë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese, nëse konstatohet se nga tejzgjatja e procesit atij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta. Në këto raste, Gjykata vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes, si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës dhe vendos për masën e dëmshpërblimit, duke iu referuar pasojave që i kanë ardhur kërkuarit nga tejzgjatja e procesit të zhvilluar para saj.

Për sa i përket numrit të çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ajo ka shënuar rritje graduale të tyre deri në vitin 2017, kur edhe ka shënuar numrin më të lartë të kërkesave të paraqitura (shih figurën nr. 2).

³⁵ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Drejt Drejtësisë. Shih <https://www.osce.org/files/f/documents/d/e/100389.pdf>

³⁶ Council of Europe, Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, November 2017, p. 8. Shih: <https://rm.coe.int/assessment-length-of-proceedings-eng/16808b7c69>

³⁷ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Drejt Drejtësisë. Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore 2013, faqe 8. Shih: <https://www.osce.org/sq/albania/100389>

³⁸ Shqyrtimi i kërkesës për pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit, kur ka kaluar në seancë plenare, përfundon brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së saj (neni 52 i ligjit). Në rastin e kërkesës për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, shqyrtimi i çështjes përfundon brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës (neni 66/a i ligjit). Kur shqyrton kërkesën për verifikimin e rezultatit përfundimtar të referendumit, Gjykata jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës (neni 67/ç).




Figura 2: Statistikat e kërkesave të paraqitura dhe çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata gjatë viteve 2007-2020

Prirja graduale e rritjes së numrit të çështjeve deri në vitin 2017 paraqet tregues pozitivë të funksionimit të Gjykatës dhe mund të interpretohet si shprehje e rritjes së besimit të qytetarëve ndaj Gjykatës. Megjithatë, numri i çështjeve gjatë viteve 2018-2020 ka rënë në mënyrë të ndjeshme për shkak të shumë faktorëve, e sidomos për shkak të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesave dhe marrjes së vendimeve si rezultat i mungesës së kuorunit.

Nga ana tjetër, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjeve brenda Gjykatës nuk është paraqitur si problematike. Me përjashtim të situatës kur vendimet nuk mund të merreshin për shkak të mungesës së kuorunit, shqyrtimi i çështjeve nga kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve në situatën aktuale ka përfunduar brenda afatit ligjor tremujor, me përjashtim të rasteve kur ligji organik përcakton afate të tjera.³⁹

Performanca në organizimin e punës është një faktor i rëndësishëm që ndikon në efikasitetin dhe efektivitetin e punës së Gjykatës. Menaxhimi i performancës në organizimin e punës përfshin masat që zbatohen në punën e përditshme të Gjykatës dhe menaxhimin e çështjeve në proces. Në këtë kontekst, Gjykata duhet të ndër marrë masa të shumanshme organizative, për shkak se,

³⁹ Nga veprimtaria e zhvilluar në datat 8 dhe 9 korrik 2020 për Strategjinë e Gjykatës Kushtuese.

potencialisht, numri i çështjeve gjatë një periudhe të afërt mund të rritet në mënyrë të shpejtë për shkak të disa faktorëve si:

- Rifillimi i punës në Gjykatën e Lartë, i cili mund të sjellë që një numër i madh vendimesh të kësaj gjykate të bëhen objekt ankimi në Gjykatën Kushtetuese.
- Efekti i zgjerimit të kompetencës së Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual.

Prandaj, përveç masave të tjera, Gjykata duhet të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së afateve kohore të brendshme dhe treguesve, që do të ndihmojnë në evitimin e vonesave në shqyrtimin e çështjeve. Po ashtu, Gjykata duhet të miratojë rregulla për përcaktimin e kategorive me prioritet, me qëllim përshpejtimin e procedurave dhe shqyrtimin e çështjeve më të rëndësishme dhe urgjente, duke kategorizuar çështjet në prioritare, të zakonshme ose edhe komplekse. Gjykata, për këtë qëllim merr parasysh kriteret që zbatohen nga GJEDNJ-ja, të tilla si: kronologjia e çështjeve; karakteri urgjent; përzgjedhja e çështjeve në mënyrë rastësore; përzgjedhja selektive e çështjeve që kanë ndikim të veçantë në të drejtat, interesat dhe liritë e shtetasve; kërkesa potencialisht të bazuara etj.

Këto kritere kanë gjetur zbatim gjatë shqyrtimit të çështjeve të mbartura për shkak të situatës së krijuar pas rënies së kuorumit ligjor të nevojshëm për shqyrtimin e çështjeve në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe në seancë plenare.

Standardizimi i afateve kohore nuk është e vetmja zgjidhje për uljen e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, por ajo është provuar si mjet i dobishëm për të vlerësuar funksionimin e politikave të gjykatës dhe për të përmirësuar ecurinë e procesit gjyqësor.

Afatet kohore mund të konsiderohen si mjete operative, sepse ato janë objektiva konkretë për të matur se në çfarë mase secila gjykatë dhe në përgjithësi administrimi i drejtësisë respektojnë afatin e duhur të shqyrtimit të çështjeve, dhe më pas respektimin e së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga KEDNJ-ja.

Një instrument, i cili mund të ndihmojë në dhënien e informacioneve për mangësitë që potencialisht mund të evidentohen në punën e Gjykatës, janë sondazhet e matjes së besimit nga ana e përdoruesve të shërbimeve të saj. Kjo lloj matjeje ose studimi mund të bëhet mbi baza të rregullta ose *ad hoc*, në varësi të modelit që zgjedh Gjykata. Metodologjia për zhvillimin e sondazheve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës mund të përdoret edhe nga Gjykata Kushtetuese.

Një sfidë tjetër, për të cilën Gjykata duhet të rrisë vëmendjen e saj, është numri i lartë, madje në rritje i vendimeve të moskalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare (shih figurën nr. 3). Gjykata duhet të ndër marrë aktivitete të shtuara informuese, të cilat mund të ofrojnë informacione konkrete për kërkuesit potencialë në lidhje me kompetencat e saj dhe procedurat

në Gjykatën Kushtetuese. Përveç kësaj, Gjykata mund të rrisë bashkëpunimin me Dhomën e Avokatisë, shoqatat dhe organizatat e ndryshme që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit, me qëllim edukimin dhe informimin e publikut për kompetencat e Gjykatës, si dhe për të drejtën e ankimit para saj.




Figura 3: Statistikat e moskalimeve dhe vendimeve përfundimtare 2007-2020

Objektivi specifik 1.2. Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre

Mjetet e përshtatshme të teknologjisë së informacionit, të cilat shërbejnë për të mbështetur veprimtarinë e gjykatës për menaxhimin e çështjeve, monitorimin dhe vlerësimin e punës së saj janë të domosdoshme për të përmirësuar performancën, ndihmojnë në evidentimin e mangësive dhe nevojave në sigurimin e menaxhimit të çështjeve në kohë reale, si dhe ofrojnë statistika të standardizuara për punën e gjykatës, menaxhimin e çështjeve të mbartura dhe sisteme të automatizuara të paralajmërimit të hershëm.⁴⁰ Megjithëse nga janari 2015 është bërë funksional Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Gjykatës Kushtetuese, ky sistem nuk ka rezultuar efektiv, ndërkohë që qëllimi i krijimit të tij ishte lehtësimi i veprimtarisë së Gjykatës. Përdorimi i këtij sistemi nga të gjithë personat e përfshirë në faza të ndryshme të veprimtarisë së Gjykatës, në

⁴⁰ European Commission, European Semester Thematic Factsheet Effective Justice Systems. 2016. Shih: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/european-semester_thematic-factsheet_effective-justice-systems_en.pdf

lidhje me çështjet në shqyrtim para saj, përbën një domosdoshmëri dhe lehtëson njëkohësisht hartimin dhe prodhimin e statistikave të plota, në kohë reale, në lidhje me çështjet në shqyrtim ose vendimmarrjen e Gjykatës. Përveç përmirësimit të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, krijimi i qasjes për stafin dhe përdorimi nga ana e tij është element esencial për funksionimin afatgjatë. Përmirësimi i udhëzuesve për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve dhe organizimi i trajnimeve janë gjithashtu të domosdoshëm. Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve duhet të mundësojë identifikimin e praktikës së mëparshme të Gjykatës dhe përmes referencave të vendimeve të Gjykatës edhe identifikimin e praktikës së GJEDNJ-së.

Kohëzgjatja e procedurave dhe menaxhimi i çështjeve në proces duhet të monitorohen nëpërmjet një sistemi të mirëpërcaktuar dhe integral të mbledhjes së informacionit. Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve mund t'i shërbejë këtij qëllimi. Mund të bëhet monitorimi automatik i çështjeve që zgjasin më shumë se një periudhë të caktuar kohore dhe sistemi mund t'i japë gjyqtarit një lloj "paralajmërimi" automatik (në adresën e-mail të tij), duke e informuar për një problem të mundshëm.⁴¹ Një sistem i monitorimit duhet, gjithashtu, të jetë në gjendje të sigurojë statistika të detajuara në kohë reale për kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në nivel të përgjithshëm, si dhe të identifikojë momente të veçanta që kanë shkaktuar kohëzgjatjet e paarsyeshme ose të tepërta. Përveç monitorimit dhe menaxhimit të procedurave gjyqësore, segmenti i monitorimit përfshin monitorimin e punës së përditshme të Gjykatës. Por parakusht për këtë është vendosja e një sistemi objektivash të Gjykatës, zërthimi i tyre në objektiva të njëjësive organizative dhe objektiva të stafit, si dhe monitorimi i arritjes së tyre.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm që ndihmon monitorimin e performancës së gjykatave janë statistikat e mbajtura dhe të publikuara, të cilat kontribuojnë në drejtim të politikave publike të drejtësisë. Statistikat gjyqësore duhet t'u japin mundësi politikëbërësve dhe praktikuesve të ligjit të marrin informacionet përkatëse për punën e gjykatës dhe cilësinë e sistemit gjyqësor, përkatësisht ngarkesën e punës të gjykatave dhe gjyqtarëve, kohëzgjatjen e nevojshme për trajtimin e kësaj ngarkese pune, cilësinë e rezultateve të gjykatave dhe sasinë e burimeve njerëzore dhe financiare që do të ndahen në sistem për të zgjidhur ngarkesën.

Gjykata Kushtetuese publikon statistikat e përgjithshme të çështjeve mbi baza vjetore. Por kërkohet përmirësimi i raportit të statistikave dhe i sistemit të statistikave përmes vendosjes së mekanizmave, procedurave, frekuencës së publikimit dhe diversifikimit të llojeve të të dhënave statistikore ose treguesve.

Një çështje tjetër që lidhet me eficiencën dhe efektivitetin e punës së Gjykatës është optimizimi dhe thjeshtimi i procedurave administrative brenda Gjykatës. Kjo përfshin edhe prirjen drejt automatizimit të proceseve të punës përmes mjeteve të teknologjisë së informacionit aty ku është e mundur, çka sjell thjeshtimin e procedurave të brendshme dhe zvogëlimin e barrës

⁴¹ Komisioni European për Eficencën e Drejtësisë (CEPEJ). Udhëzimet e SATURN-It për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore Komete dhe Shembuj Zbatimi, 2017. Shih: <https://rm.coe.int/komisioni-europian-per-eficencen-e-drejtises-pej-udhezimet-e-saturn/1680788301>

administrative për palët. Optimizimi dhe thjeshtimi i procedurave mund të aplikohet si shembull me paraqitjen e kërkesës në formë elektronike, zhvillimin e procedurave përmes teknologjisë informative, organizimin e seancave *online*, etj.

Gjykata do të krijojë mundësinë e përmirësimit të infrastrukturës fizike edhe në drejtim të ambienteve ku zhvillohen mbledhjet e kolegjeve, si dhe të infrastrukturës elektronike për sallën e gjyqit dhe atë ku zhvillohen seancat plenare mbi bazë dokumentesh për të përmirësuar transparencën, komunikimin dhe mbarëvajtjen e seancave gjyqësore.

Gjykata mund të vlerësojë, gjithashtu, krijimin e një sistemi elektronik gjurmimi, përmes të cilit palët do të kenë informacionin për statusin dhe fazën e procedurës në të cilën ndodhet çështja e tyre, pa pasur nevojë të kërkojnë informacion nga Gjykata nëpërmjet mjeteve të komunikimit ose të paraqiten fizikisht pranë saj. Palët mund të kenë akses në një sistem të tillë gjurmimi përmes faqes elektronike zyrtare, e cila duhet gjithashtu të rishikohet dhe përmirësohet.

Studim rasti: Një shembull është sistemi i gjurmimit i bazuar në barkod, i cili shërben për të ulur nevojën e publikut për t'u paraqitur fizikisht në Gjykatë. Sipas sistemit, çdo çështje e re shënohet me një barkod, i cili përmban edhe emrin e punonjësit/ve që kanë pranuar kërkesën. Çështja ka një numër identifikimi dhe sa herë që ajo përpunohet dhe ndryshon statusin, sistemi e regjistron këtë lëvizje duke lexuar barkodin. Pra, në çdo moment, sistemi jep informacion për fazën ku ndodhet çështja dhe statusin e saj. Ky informacion është i disponueshëm në faqen e internetit, në mënyrë që çdo përdorues që lidhet me këtë faqe të ketë mundësinë të informohet për statusin e kërkesës së tij. Sistemi e di se sa kohë i nevojitet çdo hapi specifik të procedurës. Ai kontrollon çdo hap dhe nëse ka një vonesë në procedurë, i dërgon automatikisht një e-mail kryesuesit të trupit gjykues dhe drejtorisë gjyqësore për të reaguar shpejt për të zgjidhur problemin.

Burimi: [Quality of Public Administration – A Toolbox for Practitioners. Topic 7.3: Modernising the justice system. https://ec.europa.eu/esf](https://ec.europa.eu/esf)

Në funksion të digjitalizimit të sistemeve, një ndihmë të rëndësishme në ushtrimin e veprimtarisë së Gjykatës ofron edhe krijimi i një arkive elektronike, e cila mundëson aksesin, në kohë reale, në materiale të ndryshme të dosjeve gjyqësore të arkivuara.

Objektivi specifik 1.3. Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese

Menaxhimi efektiv strategjik i burimeve njerëzore kërkon që Gjykata të kuptojë qartë kapacitetin e saj të burimeve, si dhe të bëjë vlerësime të arsyeshme për nevojat e saj në të ardhmen, duke marrë parasysh faktorët që ndikojnë në rritjen ose uljen e numrit të çështjeve.

Në Gjykatën Kushtetuese krijimi i Njësisë së Shërbimit Ligjor pas ndryshimeve të ligjit organik kishte për qëllim krijimin e një strukture të avancuar kërkimore për përmirësimin e cilësisë së vendimeve, si dhe rritjen e efikasitetit e efektivitetit të punës. Si një zhvillim pozitiv, aktualisht Njësia e Shërbimit Ligjor përbën bërthamën shkencore juridike dhe ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë:

përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Kryetari ose Mbledhja e Gjyqtarëve.⁴² Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë, të cilët emërohen nga Kryetari, nga radhët e juristëve që plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë, prokurorë ose juristë me përvojë jo më pak se 10 vjet si lektorë të së drejtës, avokatë ose nëpunës të lartë të administratës publike. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve⁴³. Në këtë kontekst Gjykata, gjatë viteve të fundit, ka bërë hapa të rëndësishëm në këndvështrim të vendosjes së bazës së qëndrueshme ligjore sidomos në dy aspekte:

1. Krijimin me ligj të Njesisë së Shërbimit Ligjor, e cila i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Gjykatës, dhe;
2. Rregullimin e pozicionit të këshilltarit ligjor, sidomos caktimin e pagës përmes formulës së pagës së përcaktuar nga ligji për magjistratët, përfshirë edhe pagesën për përvojën e punës.

Sipas ligjit organik të Gjykatës, jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magjistratëve. Aktualisht, Njësia e Shërbimit Ligjor ka në përbërje të saj vetëm këshilltarë nga radhët e juristëve, ndaj sfidë mbetet përcaktimi i numrit të plotë të këshilltarëve ligjorë dhe plotësimi i Njesisë edhe me këshilltarë që vijnë nga radhët e magjistratëve. Duhet theksuar, gjithashtu, se numri aktual i këshilltarëve e ka përballuar me sukses volumin e punës, megjithatë, në përcaktimin e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve, duhet të kihet parasysh edhe pritshmëria që potencialisht numri i çështjeve në Gjykatë mund të rritet në një periudhë të afërt, për shkaqet e parashtruara më lart. Përveç kësaj, duke pasur parasysh statusin e veçantë të tyre, është i nevojshëm rregullimi i sistemit të vlerësimit të performancës, masave disiplinore, të drejtave dhe përgjegjësi të tyre etj.

Një sfidë që i është paraqitur Gjykatës në të kaluarën ka qenë fokusimi në kërkime dhe studime në çështje për të cilat Gjykata ka nevojë të ketë informacion dhe analiza (p.sh. shkalla e zbatimit të vendimeve të saj). Prandaj, në të ardhmen, me qëllim të krijimit të bërthamës shkencore të Gjykatës kërkohet angazhim proaktiv i stafit të Njesisë së Shërbimit Ligjor në kërkime dhe studime për çështje të caktuara që janë me interes dhe që ndihmojnë në rritjen e cilësisë të opinioneve ligjore të tyre. Për arsye të shfrytëzimit më racional të burimeve ekzistuese të brendshme dhe të jashtme, Gjykata mund të bashkëpunojë edhe me organizata të ndryshme të specializuara për kërkime, qoftë ato të shoqërisë civile ose institucione të arsimit të lartë, si dhe të përdorë në mënyrë më proaktive “Forumit e Komisionit të Venecias”, “Rrjetin e Gjykatave Supreme” në kuadër të GJEDNJ-së, si dhe informacionet lidhur me praktikën e GJEDNJ-së, që shpërndahen nga kjo e fundit në baza javore ose mujore. Zhvillimi i kërkimeve dhe studimeve kërkon një planifikim vjetor ose afatmesëm, përmes të cilit përcaktohen temat e studimeve dhe

⁴² Neni 14/a, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

⁴³ Po aty, pika 2.

afatet kohore. Kjo ndihmon në identifikimin e burimeve financiare dhe të tjera të nevojshme, të cilat kërkojnë planifikim dhe përgatitje paraprake.

Zhvillimi dhe përdorimi i teknologjisë informative nga ana e Gjykatës kërkon, gjithashtu, rritjen e kapaciteteve të saj në menaxhimin dhe funksionimin e sistemeve elektronike. Gjykata tashmë këtë segment e mbulon vetëm me një specialist/e, duke u ndihmuar edhe nga burime përmes kontraktimit të jashtëm.

Faktorët e tjerë, të cilët ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës së gjykatës, si kapacitetet dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, në veçanti kapacitetet e Njesisë së Shërbimit Ligjor, struktura organizative, sistemi i planifikimit, menaxhimi i financave publike dhe kushtet e punës, janë pjesë e analizës dhe planifikimit në kapitujt e tjerë të këtij plani strategjik.

Objektivi specifik 1.4. Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar

Duke pasur parasysh situatën aktuale të trupës së re të Gjykatës Kushtetuese, bashkëpunimi i Gjykatës me institucionet kombëtare dhe subjekte të tjera është shumë i rëndësishëm në arritjen e synimeve dhe objektivave të saj. Me qëllim zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe atij të kushtetutshmërisë, Gjykata do të përqendrohet në forcimin e bashkëpunimit me institucione si Kuvendi, Këshilli i Ministrave, institucionet e administratës publike, ato të sistemit gjyqësor në përgjithësi, organizatat e shoqërisë civile etj. Bashkëpunimi ka për qëllim, mes të tjerash, forcimin e kapaciteteve të Gjykatës, përmirësimin e informimit, rritjen e transparencës, shkëmbimin e informacioneve, rritjen e cilësisë së studimeve dhe botimeve, si dhe përmirësimin e kushteve të punës së saj.

Bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe subjekte të tjera, sipas fushës së interesit, është pjesë përbërëse e Strategjisë dhe është trajtuar brenda analizave tematike në këtë Strategji, në varësi nga natyra e kontributit që ky bashkëpunim mund të ofrojë në arritjen e objektivave strategjikë. P.sh., siç është përmendur në kuadër të objektivit përkatës, përmirësimi i informimit dhe komunikimit me publikun kërkon bashkëpunim të Gjykatës me institucionet të cilat ndihmojnë publikun në informim dhe edukim për sa i përket rolit dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me aktorët që kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut do të jetë i rëndësishëm në informimin e palëve të interesuara në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre përmes Gjykatës Kushtetuese.

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, Gjykata ka bashkëpunim shumëpalësh dhe dypalësh me shumë organizma të rëndësishëm. Rëndësi të veçantë merr bashkëpunimi me Komisionin e Venecias dhe GJEDNJ-në, që mbështetet kryesisht në gamën e gjerë të shërbimeve që ofron Komisioni i Venecias për gjykatat kushtetuese, në mënyrë të veçantë publikimi i Buletinit për Jurisprudencën Kushtetuese, baza e të dhënave CODICES, Forumi i Venecias, Këshilli i Përbashkët për Drejtësinë Kushtetuese, opinionet *amicus curiae*, përditësimi i vazhdueshëm i informacionit për gjykatat kushtetuese, organizimi i konferencave dhe seminareve të ndryshme etj., si edhe në

mekanizmin e ri të parashikuar me Protokollin nr. 16 të KEDNJ-së për kërkesa të “kontrollit incidental” ose “opinion këshillimor” nga GJEDNJ-ja. Gjykata është, gjithashtu, anëtare me të drejta të plota e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (që prej vitit 2000); e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone (ACCF) (që prej vitit 2000); e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese (që prej vitit 2011).⁴⁴

Përveç bashkëpunimit shumëpalësh, Gjykata Kushtetuese ka bashkëpunim edhe me gjykatat e tjera kushtetuese, ku përmenden: marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Italisë, me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Turqisë. Ajo është në proces të finalizimit të marrëveshjes me Gjykatën Kushtetuese të Maqedonisë dhe atë të Spanjës.

Së fundi, Gjykata ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi edhe me OSBE-në.

Gjykata bashkëpunon me gjykatat kushtetuese të vendeve të tjera përmes takimeve të punës dhe takimeve zyrtare. Për më tepër, takimet zyrtare të punës janë mbajtur edhe me gjyqtarët e GJEDNJ-së. Gjykata, tashmë, është duke bërë përpjekje për të shtuar bashkëpunimin përmes marrëveshjeve edhe me gjykata të tjera evropiane dhe ato të rajonit, me qëllim bashkëpunimin dhe ndarjen e përvojave të tyre. Megjithatë do të duhet të thellohen përpjekjet për nënshkrimin e memorandumeve të reja të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese homologe, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm dhe intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit institucional dypalësh.

Për këtë arsye do të synohet vazhdimi i përpjekjeve për organizimin dhe realizimin e vizitave studimore të gjyqtarëve, këshilltarëve ligjorë dhe stafit administrativ të Gjykatës Kushtetuese pranë gjykatave kushtetuese homologe, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe ideve në fushën e drejtësisë kushtetuese.

Gjithashtu, duke pasur parasysh zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës për të pranuar kërkesat e individit për të gjitha shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë (të cilat në masë të madhe janë ekuivalente me të drejtat e njeriut sipas KEDNJ-së), duhet të synohet edhe rritja e bashkëpunimit me GJEDNJ-në, për të përfituar nga përvoja e saj. Kjo mund të arrihet përmes vizitave studimore, veçanërisht përmes pjesëmarrjes në programet e *traineeship* të stafit të Gjykatës në GJEDNJ për një periudhë 12-mujore, që ofrohen për zyrtarët e shteteve anëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me qëllim njohjen dhe përvetësimin e jurisprudencës së asaj gjykate.

Veprimtaritë e zhvilluara brenda ose jashtë vendit ndër vite janë të pasqyruara në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës. Një botim i ilustruar me pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme ndërkombëtare, përvjetorë jubilarë të gjykatave homologe ose kongrese dhe konferenca

⁴⁴ Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese.

Shih: http://www.gjk.gov.al/web/ORGANIZIMI_I_GJYKAT_S_KUSHTETUESE_1826_1.php

ndërkombëtare (fjalime të mbajtura nga përfaqësues të Gjykatës të shoqëruara me foto), mund të botohet në shqip dhe në anglisht.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve si në vijim:

Objektivi strategjik 1. Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv

Objektivi specifik 1.1. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve

Treguesit:

1. Koha mesatare brenda së cilës shqyrtohet një çështje, në baza vjetore.
2. Përqindja e numrit të çështjeve të pashqyrtuara nga Gjykata gjatë vitit (mbartjet), në baza vjetore.
3. Përqindja e kërkesave të kaluara për shqyrtim në seancë plenare, në baza vjetore.

Objektivi specifik 1.2. Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre

Treguesit:

1. Të gjitha çështjet e regjistruara në Gjykatë menaxhohen dhe monitorohen përmes Sistemit elektronik për Menaxhimin e Çështjeve.
2. Të gjithë nëpunësit përgjegjës të Gjykatës përdorin sistemin elektronik.
3. Numri i subjekteve, palë në proces, që përdorin sistemin për t'u informuar për statusin e çështjes së tyre, në baza vjetore.

Objektivi specifik 1.3. Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese

Treguesit:

1. Mesatarja e kohës së hartimit të projektvendimeve, opinioneve, materialeve kërkimore dhe studimore të Njesisë së Shërbimit Ligjor, në baza vjetore.
2. Të gjitha vendimet përmbajnë referenca në jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, sipas standardeve të përcaktuara.
3. Numri i studimeve të bazuara në metodologjinë e miratuar, në baza vjetore.
4. Të gjitha vendimet dhe aktet e Gjykatës u përmbahen modeleve standard dhe praktikës së saj gjyqësore.

Objektivi specifik 1.4. Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar

Treguesit:

1. Përfshirja e Gjykatës Kushtetuese në procese legislative dhe normuese që lidhen me pavarësinë e Gjykatës, në baza vjetore.
2. Numri i aktiviteteve të organizuara me institucionet vendase, në baza vjetore.
3. Numri i marrëveshjeve të nënshkruara dhe aktiviteteve të organizuara me gjykata homologe të huaja, në baza vjetore.
4. Numri i kërkesave të bëra dhe përgjigjeve të dhëna përmes Forumit të Komisionit të Venecias dhe GJEDNJ-së, duke përfshirë edhe Rrjetin e Gjykatave Supreme të GJEDNJ-së, në baza vjetore.
5. Numri i vizitave studimore dhe pjesëmarrja në konferencat e organizuara nga gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera, në baza vjetore.
6. Pjesëmarrja në konferencat e organizuara nga Gjykata e gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë nga gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera, në baza vjetore.

9. KOMUNIKIMI, INFORMIMI, TRANSPARENCA DHE BASHKËPUNIMI I GJYKATËS

Objektivi strategjik 2: Forcimi i besimit të Gjykata përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimtarisë së Gjykatës

Gjykata Kushtetuese komunikon me publikun dhe median nëpërmjet rubrikës së njoftimeve www.gjk.gov.al, nëpërmjet komunikimeve të drejtpërdrejta me gazetarët/përfaqësuesit e medias, komunikatave për shtyp, komunikimeve me individët, nëpërmjet programit të transparencës dhe kthimit të përgjigjeve në rrugë administrative.

Arritja e këtij objektivi strategjik bëhet përmes arritjes së objektivave specifike si në vijim:

Objektivi specifik 2.1	Objektivi specifik 2.2	Objektivi specifik 2.3
Rritja e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut	Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut	Forcimi i komunikimit me median

Objektivi specifik 2.1. Rritja e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut

Transparenca është element thelbësor për një funksionim efikas të sistemit të drejtësisë, pasi e fuqizon gjyqësorin me besimin dhe respektin e publikut dhe, në të njëjtën kohë, promovon një imazh pozitiv të tij. Besimi i publikut në drejtësi varet, gjithashtu, nga të kuptuarit e veprimtarisë gjyqësore dhe transparenca e punës së saj, çka është një kusht për aksesin e qytetarëve në

sistemin e drejtësisë.⁴⁵ Gjykata Kushtetuese publikon informacionin për veprimtarinë e saj përmes faqes zyrtare dhe nëpërmjet programit të transparencës, i cili përditësohet periodikisht në përputhje me nenin 5 të ligjit “Për të drejtën e informimit”⁴⁶. Informacioni i publikuar në këtë program synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së këtij institucioni nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të saj në faqen zyrtare.⁴⁷

Në përputhje me programin e ri tip të transparencës së institucioneve shtetërore, të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është duke u punuar për përmirësimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës me informacionin e nevojshëm. Megjithatë është i nevojshëm edhe përditësimi e përmirësimi i faqes zyrtare të Gjykatës në linjë me zhvillimet e reja teknologjike dhe për plotësimin e nevojave të qytetarëve për rritje të transparencës.

Marrëdhënia me publikun konsiderohet, së pari, si njohja me funksionimin dhe veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 prekën edhe aspekte të organizimit, funksionimit dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, të cilat u reflektuan si në dispozitat kushtetuese, ashtu edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e saj. Prandaj, për një qasje gjithëpërfshirëse, komunikimi me publikun duhet të jetë pjesë e një strategjie ose programi për komunikim, promovim dhe informim. Hartimi i një strategjie të tillë duhet bërë në kuadër të orientimit dhe objektivave strategjikë të Strategjisë të Gjykatës Kushtetuese (pra, kësaj Strategjie). Udhëzuesi i Këshillit të Evropës (shih më poshtë në tekstbox faqen 38) ofron një model të detajuar të Strategjisë për komunikimin me publikun, informimin dhe promovimin e punës së Gjykatës, përdorimi i të cilit mund të shërbejë në arritjen e objektivave të kësaj Strategjie.

Besimi i publikut është një nga faktorët kryesorë për legjitimitetin dhe efikasitetin e gjyqësorit në përgjithësi. Ka një njohje në rritje në vendet perëndimore se promovimi i besimit të publikut në administrimin e drejtësisë është një nga qëllimet kryesore të qeverisjes së mirë⁴⁸. Rëndësia e besimit të gjyqësorit është përmendur shprehimisht në një sërë vendimesh të GJEDNJ-së, e cila në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit në shoqëri, i cili, si garantues i drejtësisë, një vlerë themelore në një shtet të së drejtës, për të qenë i suksesshëm në kryerjen e detyrave të tij, duhet të gëzojë besimin e publikut.⁴⁹

⁴⁵ Guide on communication with the media and the public for courts and prosecution authorities.

Shih: https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-ëith-media/16809025fe#_toc524690254

⁴⁶ Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Shih: https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

⁴⁷ Faqja Zyrtare e Gjykatës Kushtetuese. Shih: http://www.gjk.gov.al/web/programi_i_transparences_1941.pdf

⁴⁸ Roberts, Julian V., Public Confidence in Criminal Justice: A Review of Recent Trends, 2004-5, University of Ottawa, p. 1.

⁴⁹ Baka v. Hungary [GC], no. 20261/12, § 164, 23 qershor 2016. In European Court of Human Rights, Judicial Seminar 2019, Strengthening the confidence in the judiciary p. 4.

Transparenca dhe publiciteti i veprimtarisë janë ndër qëllimet kryesore të gjykatave të tilla, pasi rrisin besimin ndaj gjykimit kushtetues dhe, njëkohësisht, lehtësojnë aksesin e qytetarëve në mjetet juridike⁵⁰. Ka faktorë të shumtë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët ndikojnë në besimin e publikut dhe perceptimin e tij për veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese.

Matja e besimit tek institucionet ka rëndësi, sepse perceptohet si treguesi kryesor i mirëqenies së individit dhe shoqërisë, dhe një kusht themelor i veprimit dhe bashkëpunimit kolektiv.⁵¹

Edhe pse në periudhën 2015 -2018 ka pasur matje të besimit të publikut në “sistemin gjyqësor”, në asnjë nga anketimet e opinionit të publikut nuk ka pasur pyetje specifike që lidheshin me Gjykatën Kushtetuese. Për arsye të mungesës së ndonjë matjeje të veçantë për perceptimin dhe besimin e publikut te Gjykata Kushtetuese dhe mungesës së informacioneve empirike për besimin e publikut në gjykimin kushtetues, një vend të veçantë në këtë dokument strategjik do të zërë fusha e komunikimit me publikun e, në veçanti, planifikimi i mekanizmave përmes të cilave Gjykata bën matjen e perceptimit të publikut për punën e saj. Nisur nga ky fakt, rritja e besimit të publikut ka qenë një ndër qëllimet prioritare të reformës në sistemin e drejtësisë, pavarësisht se Gjykata Kushtetuese nuk bën pjesë në sistemin e zakonshëm gjyqësor.

Matja e perceptimit të publikut mund të bëhet mbi baza të rregullta periodike, vjetore ose dyvjeçare. Përveç kësaj, Gjykata mund të zhvillojë anketime për matjen e perceptimit të publikut në periudha të caktuara, por edhe kur konsideron se kjo matje është e rëndësishme për promovimin e veprimtarisë së saj. Zhvillimi i sistemit të matjes së perceptimit të publikut bëhet përmes zhvillimit të një metodologjie dhe udhëzuesve të nevojshëm, të cilët përcaktojnë opsionet, metodat, kornizën kohore, modelin dhe informacionet e tjera që nevojiten për të arritur qëllimin e matjes së perceptimit të opinionit publik.

Objektivi specifik 2.2. Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Sipas Kushtetutës, Gjykatën Kushtetuese mund ta vërë në lëvizje: a) Presidenti i Republikës; b) Kryeministri; c) jo më pak se një e pesta e deputetëve; ç) Avokati i Popullit; d) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit; dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës; e) çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga

⁵⁰ Questions Concerning Independence of Constitutional Court as Body of State Authority, pa datë (vizituar për herë të fundit me 11/08/2020).

Shih: https://www.venice.coe.int/WCCJ/Rio/Papers/AZE_Constitutional_Court_E.pdf

⁵¹ Eurofound (2018), Societal change and trust in institutions, Publications Office of the European Union, Luxembourg. Shih: <https://www.eurofound.europa.eu/publications/report/2018/societal-change-and-trust-in-institutions> [vizituar për herë të fundit në datën 22/08/2020].

Eurofound, 2018; cituar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Sondazhi i Opinionit Publik, Besimi në Qeverisje 2019, p. 28.

Kushtetuta; ë) Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë; f) organet e qeverisjes vendore; g) organet e bashkësive fetare; gj) partitë politike; h) organizatat; i) individët.⁵²

Në këtë kuadër, përmirësimi i komunikimit me subjektet, të cilat vënë në lëvizje Gjykatën, si dhe palët e interesit të ndërlidhura me to, është në veçanti i rëndësishëm. Në funksion të kësaj Gjykata ka për qëllim të planifikojë fushata informuese për institucionet përkatëse, si dhe aktorët e tjerë të përfshirë në gjykimin kushtetues, si p.sh., Dhoma e Avokatisë, shoqatat dhe organizatat e ndryshme që mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore. Këto fushata mund të konceptohen si një seri trajnimesh/takimesh informuese njëditore të ofruara nga gjyqtarë dhe këshilltarë ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët mund të jenë edhe lektorë të së drejtës kushtetuese.

Një nga aspektet e rëndësishme të kompetencave të ridimensionuara është edhe zgjerimi i ankimit kushtetues individual, kur cenohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga çdo akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor. Në kuptim të këtyre ndryshimeve kushtetuese ka rëndësi që Gjykata të shtojë veprimtarinë e komunikimit dhe informimit të individëve për t’i informuar për të drejtën për të ushtruar ankimin kushtetues individual. Në mbështetje të kësaj është edhe fakti që numri më i madh i kërkesave para Gjykatës Kushtetuese paraqitet nga individët (shih statistikën në figurën nr. 4). Rëndësi të veçantë në këtë aspekt duhet t’u kushtohet takimeve të përbashkëta me anëtarët e Gjykatës së Lartë (si instanca më e lartë gjyqësore), vendimet e së cilës rëndom kundërshtohen në Gjykatën Kushtetuese nga individët për shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre të garantuara nga Kushtetuta.




Figura 4: Numri i kërkesave të paraqitura nga individët vs. palët tjera. Burimi: raportet vjetore të Gjykatës

⁵² Neni 134, pika 1, i Kushtetutës. Sipas pikës 2 të këtij neni subjektet e parashikuara nga nënparagrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i” mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Gjithashtu, planifikimi i fushatave informuese lidhur me rolin, kompetencat, funksionimin dhe veprimtarinë e Gjykatës, parë kjo në këndvështrimin e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, veçanërisht në drejtim të zgjerimit të juridiksionit të kësaj Gjykate, për sa i takon rritjes së aksesit të individit, janë të domosdoshme. Fushatat informuese duhen konsideruar si vazhdimësi e përpjekjeve të bëra nga Gjykata në këtë drejtim për të ecur me hapin e kohës, pra për të shfrytëzuar, në funksion të komunikimit dhe të transparencës, të gjitha mundësitë dhe gamën e mjeteve që ofron sot teknologjia e informacionit.

Mund të ndiqet si shembull i mirë praktika e GJEDNJ-së, e cila publikon video në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës, veprimtaritë e saj, kriteret dhe mënyrën e paraqitjes së kërkesës etj., si edhe praktikatat e gjykatave të tjera kushtetuese.

Nisur nga këta shembuj dhe praktika të tjera të mira, një nga veprimet konkrete që duhet ndërmarrë për realizimin e objektivit të rritjes së transparencës për veprimtarinë e Gjykatës dhe promovimit të punës së saj është pikërisht publikimi i videove në faqen zyrtare të Gjykatës dhe mjete tjera të komunikimit me publikun. Video të tilla mund të përmbajnë informacion për rolin e kësaj Gjykate në sistemin e drejtësisë, për mënyrën se si mund t'i drejtohesh asaj duke theksuar shterimin e mjeteve juridike dhe afatin kohor, modelin e paraqitjes së një kërkesë dhe mënyrën se si Gjykata merr vendimet.

Duke qëndruar te përdorimi i mjeteve të teknologjisë, disa institucione kushtetuese, p.sh., Këshilli Kushtetues Francez, Gjykata Kushtetuese e Austrisë, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës, Gjykata Supreme e Kanadasë etj., përdorin llogarinë e tyre në Twitter për të shpërndarë informacion në lidhje me vendimmarrjen e tyre, duke zgjeruar kështu bazën e informimit dhe duke u dhënë mundësi të gjithë personave të interesuar, qytetarë, juristë, magistratë e avokatë, të njihen me jurisprudencën e gjykatës dhe funksionimin e saj. Realizimi i kësaj metode informimi kërkon edhe bashkëpunimin e strukturave. Së pari, kërkon përpilimin e tekstit të përmbledhur të vendimit të marrë dhe më pas hedhjen e tij në Twitter.

Gjykata, përveçse iu komunikon zyrtarisht vendimet palëve në proces, i publikon ato (si vendimet e moskalimit, ashtu edhe ato të seancës plenare) në faqen zyrtare të internetit, me qëllim bërjen publike të veprimtarisë së saj dhe njohjen e ndjekjen nga subjektet e interesuara të jurisprudencës kushtetuese. Në këtë drejtim, një veprimtari ndihmëse do të ishte hartimi dhe publikimi i buletinit, si dhe fletëpalosjeve e broshurave për veprimtarinë e Gjykatës, ku përveç informacionit rreth rolit, strukturës dhe vendimmarrjes, të ketë edhe të dhëna statistikore për numrin dhe llojin e çështjeve të gjykuara, si dhe për anëtarësimet e Gjykatës në organizmat më të rëndësishëm ndërkombëtarë. Po me aq rëndësi do të ishte edhe organizimi i ditës së hapur për publikun, e cila mund të zhvillohet çdo vit në ditën e krijimit të Gjykatës, duke i mundësuar publikut të njihet me ambientet e punës së Gjykatës dhe të informohet në lidhje me veprimtarinë e saj. Në kuadër të kësaj dite mund të organizohen edhe veprimtari të veçanta.

Një informim më i mirë me mjete e fushata ndërgjegjësuere për sa është propozuar më sipër, do të shmangte në një masë të madhe kërkesat të cilat nuk plotësojnë kriteret për t'u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese.

Objektivi specifik 2.3. Forcimi i komunikimit me medien

Roli i medias është thelbësor për t'i siguruar publikut informacion për veprimtaritë e gjykatave.⁵³ Profesionistët e medias janë plotësisht të lirë të zgjedhin çështjet që mund të sillen në vëmendjen e publikut dhe se si duhet të trajtohen ato. Nuk duhet të bëhen përpjekje për të parandaluar medien të bëjë vlerësime kritike për organizimin ose funksionimin e drejtësisë. Gjyqësori duhet të pranojë rolin e medias, që, gjithashtu, si vëzhguese jashtë institucionit, mund të nxjerrë në pah mangësi në funksionim dhe të kontribuojë në mënyrë konstruktive në përmirësimin e praktikës gjyqësore dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për përdoruesit. CCJE-ja vlerëson se secili profesion (gjyqtarë dhe gazetarë) duhet të hartojë një kod praktike për marrëdhëniet e tij me përfaqësuesit e profesionit tjetër dhe raportimin e çështjeve gjyqësore.⁵⁴

Tashmë, prej vitesh, në Gjykatën Kushtetuese ekziston faqja zyrtare e internetit, në të cilën shfaqen informacione të përditësuara, në shqip dhe anglisht, rreth institucionit, përbërjes së tij, seancave gjyqësore, vendimmarrjes, veprimtarive të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, aksesit në gjykatë, si dhe programit të transparencës. Kjo është një formë efikase informimi që Gjykata e përdor prej kohësh. Në funksion të kësaj, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë plotëson shumë prej këtyre rubrikave. Ajo përgatit njoftime me karakter informues për veprimtari të ndryshme, si: seminare, mbledhje pune, takime pune me delegacione të gjykatave të tjera ose delegacione e përfaqësi të organizmave ndërkombëtarë; përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në kuadër të programit të transparencës.

Megjithatë, do të ishte i nevojshëm miratimi i rregullave të brendshme të komunikimit të Gjykatës me medien, të cilat do të qartësonin/saktësonin angazhimin dhe rolin e strukturave ose personave të caktuar për organizimin dhe mbarëvajtjen, si dhe hartimin e tekstit në rastet e deklaratave publike, intervistave të Kryetarit të Gjykatës, pyetjeve të bëra nga media ose qytetarët, apo edhe të njoftimeve për shtyp.

Përmirësimi i metodave të kërkimit në faqen zyrtare, duke mundësuar kërkimin sipas specifikave të çështjeve konkrete, do të ndihmonin në këtë aspekt.

Gjithashtu, është e dobishme që publiku, për çështje të veçanta, të njoftohet menjëherë për vendimin e marrë nga Gjykata.

⁵³ Consultative Council of European Judges (CCJE), Opinion no 7 (2005) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) to the attention of the Committee of Ministers on "justice and society" adopted by the CCJE at its 6th meeting (Strasbourg, 23-25 November 2005). paragrafi 9. Shih: <https://www.legal-tools.org/doc/c1d32b/pdf/>

⁵⁴ Po aty, paragrafi 33.

Në funksion të ruajtjes së imazhit ose për të evituar dëmtimin e imazhit të Gjykatës, është i nevojshëm të kryhet akreditimi i gazetarëve, në mënyrë që lajmet ose shkrimet që lidhen me vendimmarrjen apo performancën e Gjykatës të jenë sa më profesionale dhe korrekte.

Pikërisht, në këtë qasje strategjike bazë të Gjykatës, që lidhet me komunikimin me medien, po ndërmerren hapa konkretë për të bashkëpunuar edhe me partnerët ndërkombëtarë në dhënien e ekspertizës së specializuar në hartimin e këtyre rregullave.

Në situatën e zhvillimit të seancave publike pa praninë e publikut, siç janë situatat që kërkojnë marrjen ose respektimin e kufizimeve të vendosura për arsye të interesit publik (p.sh. situata e shkaktuar nga COVID-19 ku Gjykata i zhvilloi seancat plenare përgjatë gjithë kësaj periudhe vetëm në prani të palëve, por jo të publikut e medias) duhet të sigurohet përmirësimi i akteve të brendshme të Gjykatës, të cilat duhet të parashikojnë rregullat procedurale në këtë drejtim, si dhe përmirësimi i infrastrukturës elektronike në lidhje me transmetimin e seancave plenare livestream.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve si në vijim:

Udhëzuesi i Këshillit të Evropës thekson se një strategji e përgjithshme duhet:

- Të informojë publikun jo vetëm për procedurat gjyqësore, por edhe për veprimtarinë gjyqësore në tërësi.
- Të marrë parasysh përdorimin e të gjitha mjeteve të komunikimit në dispozicion, përfshirë teknologjitë e reja të informacionit dhe mjetet përkatëse.
- Të përcaktojë audiencën e synuar për secilin lloj komunikimi (publiku i gjerë, media e specializuar, gjyqtarët dhe prokurorët, politikanët, avokatët, studentët, palët në proces).
- Të identifikojë situatat në të cilat çdo grup i synuar duhet të marrë informacion.
- Të vendosë për mesazhin që autoriteti gjyqësor dëshiron të përcjellë.

Qëllimi i komunikimit gjyqësor sipas Këshillit të Evropës përfshin:

- Informimin për veprimtaritë konkrete të sistemit të drejtësisë, në veçanti çështjet (procedurat).
- Mbrojtjen e rolit të drejtësisë në shoqëri.
- Afirmimin e pavarësisë së institucioneve gjyqësore, veçanërisht kur ajo është vënë në dyshim.
- Promovimin e respektit për institucionet gjyqësore dhe përfaqësuesit e tyre.
- Formimin ose rivendosjen e besimit të qytetarëve në institucionet gjyqësore.
- Qëndrime publike për çështje me interes për drejtësinë dhe shoqërinë, nëse rrethanat e justifikojnë atë.
- Përmirësim të të kuptuarit të legjislacionit nga publiku.
- Më përgjithësisht, forcimin e imazhit të gjykatave.

Mjetet e komunikimit në dispozicion të autoriteteve gjyqësore:

- Njoftimet për shtyp: mundësojnë ofrimin e informacioneve që gjykatat synojnë t'u shpërndajnë shumë njerëzve, në parim në të njëjtën kohë.
- Konferencat për shtyp: përveç të tjerash mundësojnë ndërveprim të menjëhershëm të përfaqësuesve të medias.
- Intervista dhënë një gazetar nga një gjyqtar ose zëdhënës: si parakusht për ndërhyrjen, gjyqtari ose zëdhënësi mund të kërkojnë të kontrollojnë referencat e bëra para publikimit. Çdo entitet gjyqësor duhet të përcaktojë posaçërisht se kush ka të drejtë të pranojë intervistë.
- Përgjigje me shkrim për pyetjet e shkruara: rregullat e brendshme duhet të përcaktojnë kompetencat dhe proceset për këto përgjigje. Komunikimi duhet të përshtatet me llojin e medias në fjalë.
- Faqja zyrtare (dhe/ose aplikacioni): organizimi dhe veprimtaria e Gjykatës, seancat dëgjimore dhe ngjarjet e ardhshme, informacione të tjera nga Gjykata.
- Media sociale: në dispozicion të drejtpërdrejtë për një publik shumë të madh, pasi arrin segmente të veçanta dhe grupe të publikut.
- Konferenca dhe debate publike për tema në lidhje me drejtësinë.
- Mesazhe të filmuara: informimi i publikut për veprimtarinë e përgjithshme gjyqësore dhe aspektet e veçanta, transmetuar në televizion ose në internet (YouTube).
- Për informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë gjyqësore: dokumentacionin në dispozicion të publikut, sportelet e informacionit, ditët e "dyerve të hapura".
- Transmetimi i seancave gjyqësore specifike dhe/ose vendimeve.

Pavarësisht nga mjetet që mund të përzgjidhen, komunikimi i autoriteteve gjyqësore duhet:

- Të plotësojë nevojat e këtyre autoriteteve dhe pritjet e perceptuara dhe të supozuara të medias dhe publikut.
- Të ndërhyjë në kohën e duhur.
- Të përshtatet me audiencën e synuar.
- Të njihet nga cilësia (e vërteta faktike, objektiviteti, qartësia, mungesa e spekulimeve).

Mund të vendoset një sistem akreditimi për gazetarët brenda autoriteteve gjyqësore. Avantazhi është që gazetarët e kualifikuar mund të raportojnë për veprimtarinë gjyqësore dhe disavantazhi është që media nuk trajtohet në mënyrë të barabartë.

European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ), Guide on Communication with the Media and the Public for Courts and Prosecution Authorities, adopted at the 31st plenary meeting of the CEPEJ Strasbourg, 3 and 4 December 2018. Gjetet në Adresën https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe#_Toc5246902 (përkthimi jozyrtar nga autori i Strategjisë).

Objektivi strategjik 2. Forcimi i besimit te Gjykata përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimtarisë së Gjykatës

Objektivi specifik 2.1. Rritja e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut

Treguesit:

1. Publikimi i menjëhershëm i njoftimeve për kategori të veçanta të vendimeve.
2. Publikimi i të gjitha vendimeve të marra nga Gjykata.
3. Aktivitetet, Buletini, fjalimet, publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës.
4. Të gjitha punimet shkencore të prezantuara nga gjyqtarët në konferenca shkencore publikohen.
5. Përqindja e kërkesave të miratuara për akses në dokumente publike që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës, në baza vjetore.
6. Përqindja e rritjes së besueshmërisë së publikut te Gjykata Kushtetuese.

Objektivi specifik 2.2. Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Treguesit:

1. Rritja vjetore e përqindjes së kërkesave që kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare, si rezultat i aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese me qëllim informimin e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën.

Objektivi specifik 2.3. Forcimi i komunikimit me medien

Treguesit:

1. Numri njoftimeve të dhëna për medien, në baza vjetore.
2. Numri i konferencave për medien të mbajtura nga Gjykata, në baza vjetore.
3. Numri i përgjigjeve për kërkesat e paraqitura nga media për Gjykatën, në baza vjetore.
4. Numri i lajmeve për vendimet e Gjykatës të publikuara dhe të transmetuara në media, në baza vjetore.

10. BURIMET NJERËZORE DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE

Objektivi Strategjik 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese

Arritja e këtij objektivi strategjik bëhet përmes arritjes së objektivave specifike si në vijim:

Objektivi specifik 3.1.

Objektivi specifik 3.2.

Objektivi specifik 3.3.

Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës	Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësive të Gjykatës
---	--	---

Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj

Është pranuar se organizimi i brendshëm i një institucioni, në këtë rast i Gjykatës Kushtetuese, ka një ndikim të thellë në performancën e përgjithshme të saj, për rrjedhojë, në raport me pritshmëritë e qytetarëve. Gjykata Kushtetuese gëzon pavarësi të plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë dhe në ligjin organik.⁵⁵ Struktura organizative e Gjykatës është e parashikuar në ligjin nr. 8577/2000, Rregulloren e Brendshme të Gjykatës dhe me vendime të veçanta të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Ligji orga përcakton rregullat që kanë të bëjnë me drejtimin e Gjykatës Kushtetuese, kompetencat e Kryetarit të Gjykatës⁵⁶ dhe Mbledhjes së Gjyqtarëve,⁵⁷ si dhe në vija të përgjithshme rregullon veprimtarinë e administratës, e cila përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nëpunësit civilë etj.⁵⁸ Ligji, gjithashtu, krijon dhe rregullon Njësinë e Shërbimit Ligjor.⁵⁹ Rregullorja e brendshme e Gjykatës, në anën tjetër, rregullon më në detaje drejtimin administrativ të administratës dhe strukturën organizative të saj, përfshirë edhe përshkrimin e punës për secilën njësi në funksion të Gjykatës.

Në kuadrin e ndryshimeve ligjore të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese u bënë disa ndryshime strukturore, sidomos krijimi i Njësisë së Shërbimit Ligjor, si dhe kalimi si strukturë më vete e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes (shih figurën nr. 5 më poshtë). Këto ndryshime ligjore kanë sjellë nevojën, siç është theksuar edhe më sipër, për ndryshimin e akteve nënligjore të Gjykatës dhe përshtatjen e strukturës së saj organizative. Në varësi të nevojave të Gjykatës mund të ketë vend për ndryshime dhe përmirësime të tjera të strukturës së saj. Sidoqoftë, ndryshime të tilla duhet të paraprihen nga rishikimi dhe analiza e strukturës aktuale dhe e përzgjedhjes së modeleve më të mira, të cilat i shërbejnë më së miri Gjykatës në arritjen e objektivave të saj.

⁵⁵ Ligji nr. 8577/2000, neni 3, pika 2.

⁵⁶ Po aty, neni 12.

⁵⁷ Po aty, neni 13.

⁵⁸ Po aty, neni 14.

⁵⁹ Po aty, neni 14/a.




Figura 5: Struktura aktuale organizative e Gjykatës

Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i lidhur ngushtë me strukturën organizative të një organizate. Një strukturë organizative, koherente, racionale, me funksione dhe detyra të qarta, është parakusht për organizimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Nga ana tjetër, burimet njerëzore paraqesin një nga faktorët më të rëndësishëm për funksionimin e Gjykatës.

Administrata e Gjykatës përbëhet nga nëpunës civilë dhe punonjës të tjerë. Nëpunësit civilë të administratës së Gjykatës u nënshtrohen rregullave të shërbimit civil, për aq sa nuk bien ndesh me ligjin organik të kësaj Gjykate dhe trajtohen financiarisht njëjloj si administrata e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil dhe emërohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Statusi i këshilltarëve ligjorë është rregulluar me ligjin nr. 8577/2000 dhe ligjin që rregullon Statusin e Magjistratit⁶⁰, për aq sa ai gjen zbatim, ndërsa stafi i kabinetit ka statusin e të emëruarve politikë.

Gjykata tashmë ka të punësuar staf profesional, i cili në vetvete ka njohuri dhe përvojë të pasur. Përvoja dhe ekspertiza e gjatë dhe e larmishme e gjyqtarëve në fushën e së drejtës, përvoja dhe eksperiencia e gjatë e këshilltarëve, si dhe tradita shumëvjeçare e gjyqimit kushtetues në Shqipëri,

⁶⁰ Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

janë disa nga pikat e forta të Gjykatës. Po ashtu, edhe gatishmëria e përkushtimi i lidershit të Gjykatës dhe gjyqtarëve për zhvillimin afatgjatë dhe rritjen e performancës institucionale, mbetet një pikë e fortë e Gjykatës. Pavarësia organizative, administrative e financiare e Gjykatës Kushtetuese ka mundësuar krijimin e kushteve për të motivuar stafin profesional në mënyrë që të përballet me sfidat e punës.

Në lidhje me organikën e Gjykatës janë ende 3 vende vakante për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku njëri prej tyre do zëvendësojë gjyqtarin që i ka mbaruar mandati, por është ende në detyrë. Për këshilltarët ligjorë ka pasur një parashikim buxhetor për një numër më të madh sesa numri i këshilltarëve që aktualisht janë pjesë e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Sipas një propozimi të përgatitur nga burimet e brendshme të Gjykatës, numri i nevojshëm për një funksionim të mirë të Gjykatës është 72 punonjës, përfshirë edhe gjyqtarët. Ndërsa sipas planit buxhetor për vitin 2020 Gjykata ka të miratuar 62 punonjës dhe e njëjta situatë është edhe për planin buxhetor për vitin 2021. Numri aktual i punonjësve është 52 dhe nga numri i stafit të buxhetuar (përveç vendeve vakante të gjyqtarëve), numri i paplotësuar i punonjësve është kryesisht te Njësia e Shërbimit Ligjor (shih figurën nr. 6).




Figura 2: Numri aktual i punonjësve të Gjykatës.

Në periudhën e ardhshme afatmesme, Gjykata, përveç rekrutimit të stafit me qëllim të plotësimit të pozicioneve të punës të buxhetuara, duhet të bëjë vlerësimin nëse ka lindur nevoja për staf të ri, me qëllim ushtrimin e funksioneve të saj me efikasitet dhe eficiencë. Ky vlerësim do të ndihmojë Gjykatën për të vlerësuar gjendjen dhe nevojat e secilës njësi të Gjykatës për punonjës, sidomos pas ndryshimeve në strukturë që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit. Vlerësimi i

lartpërmendur duhet të shoqërohet nga një plan vjetor ose plan afatmesëm të personelit, i cili mund të jetë një nga instrumentet shtesë për argumentimin e kërkesave buxhetore për rritjen e numrit të stafit të Gjykatës para Ministrisë së Financave dhe Kuvendit. Plani do të shërbejë në adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të vlerësimit për nevoja për staf profesional dhe administrativ të Gjykatës.

Vlerësimi dhe planifikimi i burimeve njerëzore duhet gjithmonë të ketë parasysh qëllimin e Gjykatës në rikonceptimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sidomos ato që lidhen me kërkimin shkencor brenda Gjykatës dhe me menaxhimin e çështjeve.

Kontrolli hierarkik i brendshëm – Në ushtrimin e detyrave të nëpunësve të Gjykatës, të organizuar sipas strukturës administrative të miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve, Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm ushtrojnë kontrollin hierarkik ndaj veprimtarisë së tyre, në përputhje me kompetencat e parashikuara në ligjin nr. 8577/2000 dhe Rregulloret e Gjykatës.

Përditësimi i përshkrimeve të vendeve të punës për stafin - Ristrukturimi i disa prej njësive të Gjykatës imponon nevojën e rishikimit të përshkrimeve të punës të secilit punonjës dhe përshtatjes me rrethanat e reja të krijuara. Prandaj, si hap i parë, pas finalizimit të strukturës organizative dhe më pas miratimit të Rregullores së Brendshme të Gjykatës, kërkohet përditësimi i përshkrimeve ekzistuese të vendeve të punës për secilin punonjës individualisht, si dhe hartimi i përshkrimeve të vendeve të punës për ato pozicione që mungojnë, sipas strukturës së re organizative të miratuar.

Menaxhimi i performancës së stafit - Menaxhimi i performancës së stafit është proces i vazhdueshëm i përmirësimit të saj, përmes vendosjes së qëllimeve individuale dhe në ekip, në përputhje me qëllimet strategjike të organizatës, duke planifikuar, rishikuar dhe vlerësuar progresin, si dhe duke zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e stafit⁶¹.

Rregullimi ligjor i statusit të stafit të Gjykatës në nëpunës civilë, këshilltarë ligjorë me status magjistrati dhe të tjerë, sipas ligjeve respektive të përmendura më lart, imponon nevojën që sistemi i vlerësimit të performancës së tyre të përshtatet sipas kuadrit ligjor që rregullon secilën kategori. Vlerësimi i performancës së nëpunësve civilë të Gjykatës rregullohet me ligjin e nëpunësit civil⁶², aq sa nuk bie ndesh me ligjin organik të Gjykatës,⁶³ ndërsa vlerësimi i performancës së këshilltarëve nuk është bërë, pasi deri më sot nuk ka pasur një skemë vlerësimi. Për shkak se kuadri ligjor nuk është i mjaftueshëm dhe shpeshherë i paqartë në lidhje me këtë aspekt, plotësimi dhe shmangia e paqartësive përmes Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese është i domosdoshëm. Gjykata duhet të zhvillojë një sistem vlerësimi vjetor të performancës, objektiv dhe të besueshëm, i cili do t'i lejojë asaj të kuptojë më mirë kompetencat dhe punën e stafit të saj. Sistemi i vlerësimit duhet të jetë i lidhur ngushtë me zhvillimin e

⁶¹ Armstrong, Michael. Armstrong's Handbook of Performance Management. 2017. Online Resources. Shih: <https://www.clearreview.com/resources/guides/what-is-effective-performance-management/>

⁶² Ligji nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin nr. 41/2017).

⁶³ Neni 14, pika 5, i ligjit nr. 8577/2000.

karrierës së punonjësve dhe të adresojë kërkesat e tyre për zhvillim të kapaciteteve. Në anën tjetër, vlerësimi duhet të lidhet me një sistem shpërblimi të bazuar në meritë, si dhe anasjelltas, duhet të lejojë që situatat e performancës jo të mirë të identifikohen dhe të korrigojnë në një mënyrë objektive dhe të strukturuar.

Masat disiplinore – Procedurat disiplinore për nëpunësit civilë të Gjykatës janë të rregulluara sipas ligjit për nëpunësin civil, për aq sa nuk bien ndesh me ligjin organik të Gjykatës. Për sa u përket këshilltarëve ligjorë, neni 14/a i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se ata mbajnë përgjegjësi disiplinore dhe masat disiplinore vendosen nga Mbledhja e Gjyqtarëve, sipas Rregullores. Ata u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin organik, Rregulloren e Brendshme të Gjykatës dhe ligjin “Për statusin e Magjistratit”, për aq sa ai gjen zbatim.

Shpërndarja në disa akte e dispozitave ligjore, për sa i përket sistemit të masave disiplinore për këshilltarët ligjorë, imponon nevojën për rregullime të mëtejshme dhe detajime në Rregulloren e Brendshme të Gjykatës Kushtetuese.

Objektivi specifik 3.3. Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësisë të Gjykatës

Kapacitetet profesionale të Gjykatës, si dhe menaxhimi dhe motivimi i tyre luajnë rol kyç në pavarësinë dhe paanshmërinë e saj, si dhe efikasitetin e efektivitetin e veprimtarisë në përmbushjen e funksionit kushtetues.

Trajnimi, gjithashtu, është një element thelbësor, i cili duhet të përputhet ngushtë me nevojat dhe prioritetet e organizatës me qëllim që të përmirësojë aftësinë dhe performancën e punonjësve për punën që duhet të kryejnë. Trajnimi i synuar përfaqëson një element thelbësor në zhvillimin e karrierës, motivimin e individit dhe duhet t'u mundësojë anëtarëve të stafit të luajnë një rol më aktiv në përcaktimin e rrugës së tyre të karrierës, si dhe t'u shërbejë për të korrigjuar mangësitë në performancë.⁶⁴

Pjesëmarrja e gjyqtarëve në shkëmbime përvojash me institucione të ngjashme jashtë vendit, si dhe vizitat studimore pranë gjykatave simotra, janë të rekomandueshme për ngritjen e kapaciteteve të saj. Po ashtu, edhe marrja pjesë në aktivitete brenda ose jashtë vendit për drejtësinë kushtetuese është po aq frytdhënëse.

Po aq e rëndësishme është edhe pjesëmarrja në veprimtari trajnuese ose vizita studimore e këshilltarëve ligjorë, drejtorëve të drejtorive dhe stafit tjetër ndihmës të Gjykatës.

⁶⁴ Council of Europe, Rapporteur Group on Administrative and Budgetary Questions Progress Report, 2003. Shih: <https://rm.coe.int/09000016805df093>

Tabelat e mëposhtme tregojnë veprimtaritë e organizuara nga Gjykata dhe numrin e pjesëmarrësve në to (shih tabelat nr. 1 dhe nr. 2).

Lloji i veprimtarisë	2017	2018	2019	2020
Konferenca ndërkombëtare jashtë vendit	2 persona	3 persona	2 persona	2 persona
Vizita studimore jashtë vendit	2 persona	5 persona	-	-
Vizita studimore të gjykatave homologe në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë me ftesë të kësaj të fundit	-	-	-	-
Seminare brenda vendit	15 persona	15 persona	20 persona	15 persona
Seminare jashtë vendit	15 persona	20 persona	-	4 persona
Trajnime brenda vendit	-	-	-	-
Trajnime jashtë vendit	-	2 persona	-	7 persona
Veprimtari jubilar brenda vendit	I gjithë stafi	-	-	-

Tabela 1: Numri i veprimtarive të zhvilluara nga Gjykata Kushtetuese në vitet 2017-2020.

Lloji i veprimtarisë	2017	2018	2019	2020
Konferenca ndërkombëtare jashtë vendit	14	7	10	9 ⁶⁵
Vizita studimore jashtë vendit	1	4	-	-
Vizita studimore të gjykatave homologe në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë me ftesë të kësaj të fundit	-	-	-	-
Seminare brenda vendit	2	1	1	3
Seminare jashtë vendit	1	2	-	1
Trajnime brenda vendit	-	-	-	-
Trajnime jashtë vendit	-	1	-	2 ⁶⁶
Veprimtari jubilar brenda vendit	1	-	-	-

Tabela 2: Numrit mesatar i pjesëmarrësve në veprimtaritë e zhvilluara nga Gjykata Kushtetuese në vitet 2017-2020.

Programet e trajnimit, të cilat stafi i Gjykatës ka ndjekur është relativisht i ulët gjatë katër vjetëve të fundit (2017-2020). Në dy vjetët e fundit shkak për këtë ka qenë edhe rënia e kuorumit të

⁶⁵ 7 prej konferencave ndërkombëtare janë zhvilluar *online*, për shkak të kufizimeve të shkaktuara nga situata e pandemisë së COVID-19.

⁶⁶ Të dyja këto trajnime janë zhvilluar *online* për shkak të situatës së pandemisë të COVID-19.

gjyqtarëve, si dhe kufizimet e veprimtarive të ndryshme, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Stafi i Gjykatës ka marrë pjesë në trajnime që në shumicën e rasteve janë organizuar nga burime të jashtme. 65% ose 11 nga 17 trajnimet e organizuara gjatë periudhës 2017-2019 janë ofruar nga Shkolla Shqiptare për Administratë Publike (ASPA). Në fillim të vitit ASPA informon secilin institucion për listën e trajnimeve dhe institucionet duhet t'i zgjedhin ato nga lista. Një procedurë të tillë e ndjek edhe Gjykata ku nga lista e trajnimeve të ofruara nga ASPA ndjek trajnimet në të cilat ka interes.⁶⁷ Ofrimi i trajnimeve nga burime të jashtme, e sidomos nga ana e ASPA-s, paraqet një element pozitiv të bashkëpunimit mes institucioneve në Shqipëri dhe shfrytëzimit më efikas të burimeve financiare dhe njerëzore. Përveç kësaj, ndjekja e trajnimeve me tema të interesit të përgjithshëm i ofron nëpunësve të Gjykatës mundësi të pajisjes me njohuri, të cilat ndërlihen me funksionimin e përgjithshëm të administratës publike dhe ndihmon në menaxhimin më të mirë të saj. Megjithatë, Gjykata duhet të ketë në fokus ngritjen e kapaciteteve në fushat specifike me qëllim të përmbushjes së funksioneve të veta bazë dhe sipas një vlerësimi të nevojave të stafit për të gjitha nivelet.

Ndryshimet kushtetuese dhe ato të ligjit organik për zgjerimin e kompetencave të Gjykatës, sidomos në lidhje me ankimin kushtetues individual, nevoja për rekrutim të stafit të ri, e sidomos rritjes së numrit të këshilltarëve ligjorë, në veçanti pas plotësimit të numrit të gjyqtarëve, kërkojnë një qasje strategjike në adresimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve qoftë përmes trajnimeve, veprimtarive specifike informuese ose programeve të shkëmbimit të përvojave me gjykata të vendeve të tjera ose GJEDNJ-në. Prandaj, me qëllim të identifikimit më të mirë të nevojave të stafit të saj, kërkohet të bëhet një vlerësim i plotë i nevojave për ngritje të kapaciteteve në të gjitha nivelet e Gjykatës, përfshirë edhe prezantimin e nevojave specifike të gjyqtarëve për fusha të veçanta të interesit të tyre.

Procedura e vlerësimit të nevojave për trajnime është e lidhur ngushtë me procedurën për vlerësimin e performancës së stafit. Në fakt është evidentuar se kjo nuk është zhvilluar si një procedurë efektive, prandaj ka ndikuar në mungesën e identifikimit të nevojave të trajnimit. Si procedurë ajo kryhet në fund të secilit vit kalendarik. Në pjesën e fundit të procedurës për vlerësimin e performancës, eprori dhe vartësi duhet t'i paraqesin nevojat e trajnimit të vlerësuarit. Njësia e Burimeve Njerëzore në Gjykatë duhet të mbledhë të gjitha informacionet nga formularët për vlerësimin e performancës dhe të paraqesë nevojat për trajnim për institucionin. Rrjedhimisht, këto nevoja duhet të transformohen në një plan për zhvillim institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të Gjykatës. Një plan i tillë do të pasohet nga hartimi i programeve për trajnimin e stafit.

⁶⁷ Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur trajnime të stafit të organizuara nga ASPA.
Gjatë vitit 2019 stafi ka marrë pjesë në 7 trajnime të organizuara nga ASPA.
Gjatë vitit 2018 stafi ka marrë pjesë në 2 trajnime të organizuara nga ASPA.
Gjatë vitit 2017 stafi ka marrë pjesë në 2 trajnime të organizuara nga ASPA.

Plani afatmesëm i trajnimeve do të përfshijë disa kategori të programeve të trajnimeve si:

- Programe trajnimi për stafin profesional, të cilët merren me shqyrtimin e çështjeve që i drejtohen Gjykatës.
- Programe për trajnime fillestare për punonjësit e rinj, të cilët rekrutohen ose planifikohen të rekrutohen.
- Programe trajnimi ose forcim të kapaciteteve për stafin e shërbimeve të administratës së Gjykatës.
- Programe të shkëmbimit të përvojave me gjykata të vendeve të tjera ose GJEDNJ-në.

Një plan i trajnimeve dhe programeve të zhvilluara të trajnimeve, sipas nevojave të stafit të Gjykatës, ka kosto të konsiderueshme dhe me buxhetin aktual do të jetë i papërbalueshëm. Prandaj, një plan strategjik për ngritjen e kapaciteteve të saj do të jetë bazë e fortë diskutimi me Kuvendin për argumentimin e kërkesave buxhetore për Gjykatën. Përveç kësaj, plani dhe programet e trajnimit do të shërbejnë në përmirësimin e bashkëpunimit me partnerët e jashtëm në ofrimin e asistencës teknike dhe bashkërendimin e programimit të fondeve të donatorëve për mbështetje të mëtejme për Gjykatën gjatë një periudhe të ardhshme afatmesme.

Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve - Pas një periudhe të caktuar të zbatimit të planit të propozuar për trajnimin e stafit të Gjykatës, Njësia e Burimeve Njerëzore do të bëjë një vlerësim të ndikimit që trajnimet kanë pasur në përmirësimin e performancës së stafit në fushat në të cilat është ndjekur trajnimi. Duhet vlerësuar se nevojat e stafit për trajnime dhe zhvillim të aftësive të tyre do të jenë të vazhdueshme. Prandaj, dhe vlerësimi i ndikimit të trajnimeve do të shërbejë edhe si bazë për të planifikuar vazhdimin e trajnimeve për periudhën pas përfundimit të ciklit të trajnimeve të planifikuara.

Matja për arritjen e objektivave specifike të kësaj fushe bëhet përmes treguesve si në vijim:

Objektivi strategjik 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese
Objektivi specifik 3.1. Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj
Treguesi: <ol style="list-style-type: none">1. Të gjitha njësitë organizative i kanë përgjegjësitë e përcaktuara qartë.
Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës
Treguesi: <ol style="list-style-type: none">1. Të gjithë nëpunësit e kanë të përcaktuar përshkrimin e vendit të punës.2. Të gjithë nëpunësit dhe këshilltarët të vlerësuar në mënyrë periodike.

Objektivi specifik 3.3. Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësive të Gjykatës

Treguesi:

1. Numri i vendeve vakante të plotësuara.
2. Numri i stafit në njësitë organizative që lidhen me funksionin e Gjykatës.
3. I gjithë stafi i ri i trajnuar.
4. Numri i stafit që merr pjesë në trajnime, vizita studimore, konferenca e programe shkëmbimi, në baza vjetore.

11. MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE DHE SIGURIMI I KUSHTEVE TË PUNËS TË GJYKATËS

Objektivi i strategjik 4. Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Arritja e këtij objekti strategjik bëhet përmes arritjes së objektivave specifikë si në vijim:

Objektivi specifik 4.1.	Objektivi specifik 4.2.	Objektivi specifik 4.3.	Objektivi specifik 4.4.
Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës	Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës	Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën	Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Objektivi specifik 4.1. Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës

Financimi i Gjykatës, në kontekstin e pavarësisë së saj për të administruar buxhetin, është trajtuar më lart në rubrikën që lidhet me pavarësinë, paanësinë dhe funksionimin e saj. Mbështetja e veprimtarisë së Gjykatës nëpërmjet administrimit me efektivitet të fondeve buxhetore për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin normal të punës së anëtarëve të Gjykatës dhe aparatit administrativ, bëhet nga Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore. Menaxhimi i financave publike nga ana e Drejtorisë bëhet sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar” dhe ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndër sfidat kryesore të cilat prekin pavarësinë e Gjykatës, e garantuar në Kushtetutë dhe në ligjin organik, janë mosmiratimi i buxhetit të kërkuar dhe shpeshherë fakti që për secilin ndryshim që

lind i nevojshëm gjatë procesit të zbatimit të tij nga zërat e caktuar buxhetorë, kërkohet të merret edhe leje nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për të evituar këto sfida, siç është trajtuar edhe në rubrikën 6.2. (Financimi i Gjykatës Kushtetuese), kërkohet aktivizimi i Gjykatës në ndërmarrjen e veprimtarive sensibilizuese përmes bashkëpunimit më të ngushtë me Kuvendin, organizimin e konferencave dhe diskutimeve publike me palët kryesore të interesuara. Mjetet e komunikimit me publikun dhe me aktorët përgjegjës të institucioneve përkatëse duhet të shfrytëzohen në maksimum, përfshirë kohën para dhe gjatë periudhës vjetore kur zhvillohet procesi i planifikimit dhe i vendimmarrjes për buxhetin.

Nga ana tjetër, ekziston nevoja për forcimin e planifikimit afatmesëm dhe atij vjetor të buxhetit. Bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë e tjera të Gjykatës dhe koordinimi i përfortuar për planifikimin afatmesëm dhe vjetor të buxhetit do të mundësojë planifikim më të mirë, të kuptuarit e përbashkët dhe koordinim të përmirësuar në fushën e buxhetit dhe financave. Do të lobohet pranë Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me kërkesën kushtetuese për pavarësi financiare, lidhur me miratimin e fondeve buxhetore të Gjykatës dhe shpërndarjen e tyre sipas nevojave të saj. Si pjesë e këtyre veprimtarive Gjykata, gjithashtu, planifikon dhe përgatit mënyrat për të artikuluar më mirë dhe për të prezantuar nevojat para komisioneve parlamentare të Kuvendit.

Kjo Strategji dhe mekanizmat e saj të koordinimit dhe monitorimit do të ndihmojnë në përmirësimin e koordinimit të planifikimit afatmesëm dhe atij vjetor të buxhetit të Gjykatës, por edhe për identifikimin dhe planifikimin e burimeve tjera.

Objektivi specifik 4.2. Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës

Me qëllim të përfitimit të ndihmës dhe projekteve të jashtme donatore, si dhe shfrytëzimin e tyre efektiv në mbështetje të arritjes së objektivave dhe prioriteteve të Gjykatës, është shumë i rëndësishëm thellimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët. Forcimi i këtij bashkëpunimi mund të ndihmojë Gjykatën të plotësojë mungesën buxhetore për projektet, të cilat janë përfshirë në Strategji e që nuk mund të mbulohen nga buxheti i shtetit. Bashkëpunimi i vazhdueshëm që Gjykata ka me prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Fondacionin KAS, Zyra për Shqipërinë, përfshirë edhe mbështetjen e tyre në hartimin e kësaj Strategjie, është një shembull që duhet ndjekur edhe me partnerët e tjerë ndërkombëtarë. Për sa më sipër, krahas vijimit të bashkëpunimit me OSBE-në dhe KAS-in, Gjykata do të bashkëpunojë edhe me partnerë të tjerë që kanë shprehur vullnetin e tyre për t'u angazhuar në realizimin e këtij Plani Strategjik. Gjykata do të identifikojë nevojat e veta dhe projektet për të cilat ka nevojë për financim nga donatorët. Ajo do të organizojë tryeza, takime bilaterale dhe tryeza të përbashkëta me organizatat donatore, me qëllim prezantimin dhe diskutimin e nevojave të Gjykatës dhe projekteve të identifikuar.

Objektivi specifik 4.3. Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën

Strategjia për Menaxhimin e Riskut dhe kontrolli i zbatimit të saj ndihmon në identifikimin, analizën, vlerësimin, trajtimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve kryesore që rrezikojnë realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Gjykatës Kushtetuese, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Në këtë aspekt, Gjykata do të ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Riskut dhe hartimin e dokumenteve të tjera të nevojshme, si dhe krijimin e mekanizmave për menaxhimin e riskut, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të saj.

Objektivi specifik 4.4. Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Gjykatës i mungojnë ambientet dhe pajisjet e nevojshme për një funksionim më efikas. Problematike për Gjykatën Kushtetuese ka qenë edhe mungesa e hapësirave infrastrukturore, si ambiente komode pune ose mangësi financiare për t'iu përshtatur teknologjisë bashkëkohore të kërkimit shkencor, me qëllim funksionimin efektiv dhe cilësor të saj, si dhe rritjes së transparencës ndaj publikut.

Gjykata ka selinë e saj në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 26, Tiranë, godinë në të cilën janë vendosur disa institucione kushtetuese. Ambientet në këtë ndërtesë janë të mangëta, duke filluar nga zyrat, të cilat me shtimin e parashikuar të stafit, janë të pamjaftueshme. Përveç kësaj, salla e gjyqimit është e vogël dhe e papërshtatshme. Megjithëse këta janë faktorë të jashtëm që nuk varen nga Gjykata, mungesa e kushteve të mira të punës cenon efektivitetin e punës. Gjykata synon të ndërmarrë aktivitete sensibilizuese dhe koordinim intensiv me institucionet përkatëse për realizimin e këtij objekti.

Matja për arritjen e objektivave specifikë të kësaj fushe bëhet përmes treguesve si në vijim:

Objektivi strategjik 4. Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Objektivi specifik 4.1. Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës

Treguesit:

1. Përqindja e buxhetit të miratuar të Gjykatës e shpenzuar brenda vitit.
2. Përqindja e rritur e buxhetit vjetor.
3. Institucionet e tjera me rëndësi (Qeveria, Kuvendi) të sensibilizuara për pavarësinë buxhetore dhe nevojat buxhetore të Gjykatës.
4. Të gjitha njësitë organizative të Gjykatës të përfshira në planifikimin e nevojave buxhetore.

Objektivi specifik 4.2. Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës

Treguesit:

1. Numri i projekteve të financuara nga donatorët.
2. Numri i aktiviteteve të financuara nga donatorët, në të cilat Gjykata merr pjesë.
3. Përqindja e shumës së projekteve të financuara nga donatorët në raport me buxhetin e Gjykatës.

Objektivi specifik 4.3. Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën

Treguesit:

1. Numri i risqeve të ndodhura.
2. Numri i objektivave të Strategjisë për Menaxhimin e Riskut, të plotësuar.

Objektivi specifik 4.4. Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës

Treguesit:

1. Hapësirat e mjaftueshme të punës, të siguruara.
2. Mjetet e nevojshme të punës, të siguruara.

12. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË SË GJYKATËS KUSHTETUESE

Strategjia për Gjykatën Kushtetuese do të përbëjë kornizën kryesore për monitorimin dhe raportimin e zhvillimit strategjik dhe reformues të saj në periudhën e ardhshme afatmesme.

Mekanizmi i monitorimit të saj përbëhet nga:

- Struktura koordinuese e monitorimit dhe raportimit
- Proceset e monitorimit dhe raportimit

Struktura koordinuese e monitorimit dhe raportimit – Përbëhet nga drejtorët e drejtorive të Gjykatës dhe udhëhiqet nga Kryetari ose Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës. Gjykata mund të zgjerojë përgjegjësinë dhe objektin e veprimtarisë së Grupit të Planifikimit Strategjik të krijuar për hartimin e Strategjisë edhe gjatë monitorimit e raportimit të zbatimit të saj, edhe rishikimin e Strategjisë pas periudhës së caktuar kohore. Roli dhe përgjegjësia e grupit, procedurat e punës, frekuenca e takimeve dhe raportimeve mund të caktohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Proceset e monitorimit dhe raportimit – Raportimi i zbatimit të Strategjisë bëhet në baza 3-mujore ose 6-mujore, si dhe në baza vjetore. Raporti i përgjithshëm, përmes të cilit bëhet vlerësimi i zbatimit të Strategjisë dhe arritjes së objektivave strategjike, bëhet në vitin e fundit të saj. Raporti 3-mujor ose 6-mujor fokusohet në progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve, përfshirë këtu respektimin e afateve, arsyet nëse ka pasur vonesa, sfidat në zbatim etj. Raporti vjetor fokusohet në progresin e arritur kundrejt objektivave specifike dhe treguesve të suksesit.

Për të lehtësuar procesin e raportimit dhe monitorimit, Gjykata mund të zhvillojë format standarde të mbledhjes së informatave të raportimit, formatin standard të raportit periodik (3 dhe 6-mujor), formatin standard për raportin vjetor dhe atë përfundimtar.

13. NDIKIMI FINANCIAR I STRATEGJISË

Vlerësimi i kostos financiare për zbatimin e Strategjisë është bazuar në: a) vlerat referente të pranuar drejtpërdrejt nga takimet me nëpunësit përgjegjës për financat në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë; b) vlerat referente të ndikimit financiar të përdorura në strategjitë e draftuara për institucionet e Republikës së Shqipërisë; si dhe c) informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për qëllim të vlerësimit të kostos së inputeve dhe produkteve të planifikuara që realizohen me planin e zbatimit të Strategjisë së Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në këto informacione është krijuar një referencë e çmimeve të përafërta, sipas të cilave është bërë kostimi i produkteve dhe aktiviteteve të planit të zbatimit.

Qasja e ndjekur në këtë vlerësim është që fillimisht janë dhënë objektivat e synuar (strategjikë dhe specifike) dhe janë analizuar veprimet (aktivitetet), dhe rezultatet e ndërlidhura për ato aktivitete të nevojshme për të arritur objektivat. Për çdo aktivitet janë vlerësuar edhe burimet e mundshme të financimit, të cilat do të mund të mbulojnë nga buxheti i Gjykatës/shtetit dhe/ose nga donatorët e mundshëm. Megjithatë, aktivitetet të cilat zbatohen nga Gjykata, duke përdorur burimet e saj aktuale njerëzore, nuk janë kostuar në mënyrë të ndarë dhe për ato aktivitete është shënuar se zbatohen “pa kosto shtesë”. Rrjedhimisht, kostoja totale e parashikuar në këtë Strategji nënkupton, në parim, shumën e nevojshme financiare për aktivitetet, të cilat ka të dhëna se nuk janë planifikuar të mbulojnë me burimet aktuale të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kjo shumë duhet të mbulohet përmes ripriorizimit të buxhetit aktual dhe kërkesave shtesë nga buxheti i tanishëm i shtetit, si dhe nga donatorët e mundshëm.

Më poshtë është paraqitur vlerësimi i kostos financiare të drejtpërdrejtë për zbatimin e Strategjisë, sipas objektivave strategjikë dhe specifike, e ndarë në vitet përkatëse:

Tabela: Ndikimi financiar i Strategjisë së Gjykatës për vitet 2021-2023, sipas Objektivave Strategjike (shumat në EUR dhe ALL⁶⁸)

		2021	2022	2023	Total
Objektivi strategjik #1	Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv	101,584.00	188,034.00	282,433.00	572,051.00
		EUR	EUR	EUR	EUR
		12,522,259	23,178,951	34,815,516	70,516,726
		ALL	ALL	ALL	ALL
Objektivat specifike	O.S. # 1.1 Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve	8,050.00 EUR 992,323 ALL	15,000.00 EUR 1,849,050 ALL	20,900.00 EUR 2,576,343 ALL	43,950.00 EUR 5,417,716 ALL
	O.S. # 1.2 Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për	17,000.00 EUR	10,600.00 EUR	100,000.00 EUR	127,600.00 EUR

⁶⁸ Llogaritja e vlerës në ALL është bërë në bazë të kursit zyrtar të këmbimit, të publikuar nga Banka e Shqipërisë, datë 29.03.2021, data e miratimit të kësaj Strategjie. Sipas këtij kursi 1 euro konvertohet në 123,27 lekë.

Shih: https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/

	menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre	2,095,590 ALL	1,306,662 ALL	12,327,000 ALL	15,729,252 ALL
	O.S. # 1.3 Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese	35,334.00 EUR	41,234.00 EUR	40,333.00 EUR	116,901.00 EUR
	O.S. # 1.4 Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar	4,355,622 ALL	5,082,915 ALL	4,971,849 ALL	14,410,386 ALL
	O.S. # 1.4 Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar	41,200.00 EUR	121,200.00 EUR	121,200.00 EUR	283,600.00 EUR
	O.S. # 1.4 Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar	5,078,724 ALL	14,940,324 ALL	14,940,324 ALL	34,959,372 ALL
Objektivi strategjik #2	Forcimi i besimit te Gjykata përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimitarisë së Gjykatës	81,550.00 EUR 10,052,668 ALL	5,500.00 EUR 677,985 ALL	6,500.00 EUR 801,255 ALL	93,550.00 EUR 11,531,908 ALL
Objektivat specifike	O.S. # 2.1 Rritja e transparencës së veprimitarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut	37,100.00 EUR	0	1,000.00 EUR	38,100.00 EUR
	O.S. # 2.2 Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut	4,573,317 ALL	900.00 EUR	123,270 ALL	4,696,587 ALL
	O.S. # 2.2 Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut	900.00 EUR	900.00 EUR	900.00 EUR	2,700.00 EUR
	O.S. # 2.2 Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut	110,943 ALL	110,943 ALL	110,943 ALL	332,829 ALL
	O.S. # 2.3 Forcimi i komunikimit me medien	43,550.00 EUR	4,600.00 EUR	4,600.00 EUR	52,750.00 EUR
	O.S. # 2.3 Forcimi i komunikimit me medien	5,368,408 ALL	567,042 ALL	567,042 ALL	6,502,492 ALL
Objektivi strategjik #3	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese	13,400.00 EUR 1,651,818 ALL	97,000.00 EUR 11,957,190 ALL	5,900.00 EUR 727,293 ALL	116,300.00 EUR 14,336,301 ALL
Objektivat specifike	O.S. # 3.1 Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj	0	0	0	0
	O.S. # 3.2 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës	13,400.00 EUR	7,000.00 EUR	5,900.00 EUR	26,300.00 EUR
	O.S. # 3.2 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës	1,651,818 ALL	862,890 ALL	727,293 ALL	3,242,001 ALL
	O.S. # 3.3 Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësive të Gjykatës	0	90,000.00 EUR	0	90,000.00 EUR
	O.S. # 3.3 Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësive të Gjykatës		11,094,300 ALL		11,094,300 ALL
Objektivi strategjik #4	Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet	12,200.00 EUR	10,000.00 EUR	1,511,200.00 EUR	1,533,400.00 EUR

	e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës	1,503,894 ALL	1,232,700 ALL	186,285,624 ALL	189,022,218 ALL
Objektivat specifikë	O.S. # 4.1 Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës	1,200.00 EUR 147,924 ALL	0	1,200.00 EUR 147,924 ALL	2,400.00 EUR 295,848 ALL
	O.S. # 4.2 Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës	1,000.00 EUR 123,270 ALL	0	0	1,000.00 EUR 123,270 ALL
	O.S. # 4.3 Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën	0	0	0	0
	O.S. # 4.4 Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës	10,000.00 EUR 1,232,700 ALL	10,000.00 EUR 1,232,700 ALL	1,510,000.00 EUR 186,137,700 ALL	1,530,000.00 EUR 188,603,100 ALL
	TOTAL	208,734.00 EUR 25,730,639 ALL	300,534.00 EUR 37,046,826 ALL	1,806,033.00 EUR 222,629,688 ALL	2,315,301.00 EUR 285,407,153 ALL

Sikurse është paraqitur në tabelën më sipër, kostoja totale financiare për zbatimin e Strategjisë është **EUR 2,315,301.00 ose e konvertuar në ALL 285,407,154.**

Objekti #1 Strategjik *“Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv”* vlerësohet të ketë kosto në shumën **EUR 572,051.00 ose e konvertuar në ALL 70,516,726.**

Objekti #2 Strategjik *“Forcimi i besimit të Gjykata përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimtarisë së Gjykatës”* vlerësohet të ketë kosto **EUR 93,550.00 ose e konvertuar në ALL 11,531,908.**

Objekti #3 Strategjik *“Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese”* vlerësohet të ketë kosto në shumën **EUR 116,300.00 ose e konvertuar në ALL 14,336,301.**

Objekti #4 Strategjik *“Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës”* vlerësohet të ketë kosto në shumën **EUR 1,533,400.00 ose e konvertuar në ALL 189,022,218.**

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
2021-2023**

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:						
I.	Sigurimi i një sistemi funksional të drejtësisë kushtetuese dhe një mjeti ankimi efikas dhe efektiv					
1.1.	Objektivi Specifik	Treguesit				
	Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e shqyrtimit të çështjeve	1. Koha mesatare brenda së cilës shqyrtohet një çështje, në baza vjetore.				
		2. Përqindja e numrit të çështjeve të pashqyrtuara nga Gjykata gjatë vitit (mbartjet), në baza vjetore.				
		3. Përqindja e kërkesave të kaluara për shqyrtim në seancë plenare, në baza vjetore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
1.1.1	Miratimi i procedurave të brendshme për menaxhimin e çështjeve, hapave dhe afateve që duhen ndjekur për trajtimin e tyre	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2021	900.00 EUR ose	Buxheti i Gjykatës (BGJ)	Miratimi i Rregullores për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

				110,943 ALL		
1.1.2	Përmirësimi i regjistrave të punës që administrohen nga Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit	Sekretari i Përgjithshëm/ DGJD	T2 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Miratimi i llojeve dhe modelit të regjistrave të punës dhe akteve standarde të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit
1.1.3.	Përditësimi i Udhëzuesit për plotësimin e formularit për paraqitjen e ankimit kushtetues	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Njësia e Shërbimit Ligjor	Çdo 2 vite, duke filluar nga T4 2022	(2 herë) 11,800.00 EUR ose 1,454,586 ALL	BGJ/donatorë	Guida e përmirësuar dhe e aksesueshme
1.1.4.	Monitorimi vjetor lidhur me zbatimin e vendimeve	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Njësia e Shërbimit Ligjor/DGJD	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Ngritja e Grupit të Punës për monitorimin e zbatimit të vendimeve
1.1.5	Miratimi i metodologjisë dhe i modelit të sondazhit për besimin publik te Gjykata Kushtetuese	Sekretari i Përgjithshëm/D MJP	T4 2021	7,150.00 EUR ose 881,380 ALL	Donatorë	Metodologjia dhe modeli i sondazhit për matjen e besimit publik te Gjykata Kushtetuese të miratuara
1.1.6	Organizimi i sondazheve për efencën dhe efikasitetin e veprimtarisë së Gjykatës, bazuar në metodologjinë e miratuar	Sekretari i Përgjithshëm/D MJP	1 herë në 2 vjet	30,000.00 EUR ose	Donatorë	2 sondazhe të organizuara për besimin publik te Gjykata Kushtetuese

				3,698,100 ALL		
1.2	Objektivi Specifik	Treguesit				
Sigurimi i një sistemi elektronik funksional dhe bashkëkohor për menaxhimin e çështjeve dhe monitorimin e tyre		1. Të gjitha çështjet të regjistruara në Gjykatë menaxhohen dhe monitorohen përmes Sistemit elektronik për Menaxhimin e Çështjeve.				
		2. Të gjithë nëpunësit përgjegjës të Gjykatës përdorin sistemin elektronik.				
		3. Numri i subjekteve, palë në proces, që përdorin sistemin për t'u informuar për statusin e çështjes së tyre, në baza vjetore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
1.2.1.	Funksionimi i Sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve	Sekretari i Përgjithshëm/ DGJD	T4 2021	17,000.00 EUR ose 2,095,590 ALL	BGJ/Donatorë	Sistemi elektronik për regjistrimin, menaxhimin dhe monitorimin e çështjeve është krijuar dhe është funksional, dhe mes të tjerash, përmban të skanuara të gjitha aktet e dosjes së çështjes e lejon nxjerrjen e statistikave sipas kriterëve të përcaktuara, duke përfshirë statistika sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën, karakteristikat e çështjeve,

						fazën e shqyrtimit, kohëzgjatjen e çështjeve në secilën fazë të shqyrtimit dhe paralajmërimin në rast të kohëzgjatjes ose kompleksitetit/rëndësisë së çështjes
1.2.2.	Përmirësimi i Udhëzuesit për përdorimin e Sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve	Sekretari i Përgjithshëm/ DGJD	T1 2022	5,900.00 EUR ose 727,293 ALL	BGJ/donatorë	Udhëzuesi për përdorimin e sistemit elektronik për menaxhimin dhe monitorimin e çështjeve, i përmirësuar
1.2.3.	Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të stafit, në veçanti në administrimin e Sistemit elektronik të Menaxhimit të Çështjeve	Njësia e Shërbimit Ligjor/DGJD	T2 2022	4,700 EUR ose 579,369 ALL	donatorë	Nëpunësit e Gjykatës të trajnuar për përdorimin e sistemit elektronik
1.2.4	Krijimi i sistemit të monitorimit të statusit të çështjeve nga palët në gjykim	DGJD	T4 2021	Kosto në 2.1.5	donatorë	Faqja zyrtare e rishikuar/palët kanë akses në sistem, i cili u mundëson të informohen për fazën ku ndodhet çështja e tyre
1.2.5	Automatizimi i procedurave dhe komunikimit me palët dhe institucionet tjera, si dhe paraqitja e kërkesave nga kërkuesit në mënyrë elektronike	Mbledhja Gjyqtarëve	T4 2023	Kosto në 1.2.1	donatorë	Rregulloret e Gjykatës të miratuara
1.2.6	Krijimi i Arkivës Elektronike	DGJD	T4 2023	100,000.00 EUR	donatorë	Arkiva elektronike e krijuar

				ose 12,327,000 ALL		
1.3	Objektivi Specifik	Treguesit				
Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor, studimeve, si dhe ruajtja dhe zhvillimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese		1. Mesatarja e kohës së hartimit të projektvendimeve, opinioneve, materialeve kërkimore dhe studimore të Njësisë së Shërbimit Ligjor, në baza vjetore.				
		2. Të gjitha vendimet përmbajnë referenca në jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, sipas standardeve të përcaktuara.				
		3. Numri i studimeve të bazuara në metodologjinë e miratuar, në baza vjetore.				
		4. Të gjitha vendimet dhe aktet e Gjykatës i përmbahen modeleve standard dhe praktikës së saj gjyqësore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efektet Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
1.3.1.	Përcaktimi i qartë i përgjegjësive brenda Njësisë së Shërbimit Ligjor që lidhen me hartimin e vendimeve, si dhe përgatitjen e kërkimeve dhe studimeve gjatë shqyrtimit të çështjeve	Mbledhja e gjyqtarëve	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Rregullorja për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

1.3.2.	Plotësimi i vendeve të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor duke përfshirë këshilltarët nga radhët e magistratëve	Kryetari/ DEBNJ	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Të gjitha pozicionet e punës në Njësinë e Shërbimit Ligjor të plotësuara
1.3.3.	Rritja në mënyrë progresive e numrit të këshilltarëve ligjorë	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2022 T4 2023	Pa kosto shtesë	BGJ	5 këshilltarë të rinj (përveç atyre të buxhetuar) 3 këshilltarë të rinj (përveç atyre të buxhetuar)
1.3.4.	Organizimi i trajnimeve me fokus në çështjet e drejtësisë kushtetuese bazuar në kalendarin vjetor	DEBNJ/DMPJ	Në Vazhdimësi	26,000.00 EUR ose 3,205,020 ALL	BGJ/donatorë	2 trajnime të organizuara në vit
1.3.5.	Organizimi i vizitave studimore në gjykata kushtetuese/supreme të shteteve të tjera dhe gjykata ndërkombëtare, si dhe shfrytëzimi i mundësive për programe trajnimi ose intership të GJEDNJ-së	DMPJ	Në vazhdimësi	80,000.00 EUR ose 9,861,600 ALL	BGJ/donatorë	1 vizitë studimore në vit dhe pjesëmarrja në programet e trajnimit ose intership në GJEDNJ
1.3.6	Hartimi dhe miratimi i metodologjisë për kërkimin dhe studimin shkencor lidhur me standardet ndërkombëtare dhe analiza krahasimore	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Njësia e Shërbimit Ligjor	T4 2021	5,900.00 EUR ose 727,293 ALL	BGJ/donatorë	Metodologjia e studimeve dhe e kërkimit shkencor e miratuar 2 studime në vit

			T3 2022			
1.3.7	Krijimi i modeleve standard (formularëve tip) të akteve të dosjes gjyqësore (opinione, projektvendime etj.), duke përfshirë përcaktimin e metodologjisë së sistemit të referencave	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Njësia e Shërbimit Ligjor	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Formularët tip dhe metodologjia të miratuara
1.3.8	Përmirësimi i databazës që përmban praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe mundësia e filtrimit të çështjeve sipas fjalëve kyçe/karakteristikave të çështjes	Njësia e Shërbimit Ligjor/DGJD	T1 2022	5,000.00 EUR ose 616,350 ALL	BGJ/donatorë	Databaza e kompletuar
1.4	Objektivi Specifik	Treguesit				
Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit të Gjykatës me institucionet vendase dhe ato në nivel ndërkombëtar		1. Përfshirja e Gjykatës Kushtetuese në procese legjislative dhe normuese që lidhen me pavarësinë e Gjykatës, në baza vjetore.				
		2. Numri i aktiviteteve të organizuara me institucionet vendase, në baza vjetore.				
		3. Numri i marrëveshjeve të nënshkruara dhe aktiviteteve të organizuara me gjykata homologe të huaja, në baza vjetore.				
		4. Numri i kërkesave të bëra dhe përgjigjeve të dhëna përmes Forumit të Komisionit të Venecias dhe GJEDNJ-së, duke përfshirë edhe Rrjetin e Gjykatave Supreme të GJEDNJ-së, në baza vjetore.				
		5. Numri i vizitave studimore dhe pjesëmarrja në konferencat e organizuara nga gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera, në baza vjetore.				

		6. Pjesëmarrja në konferencat e organizuara nga Gjykata e gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë nga gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera, në baza vjetore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efektet Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
1.4.1	Pjesëmarrja aktive në nisma ligjore të Qeverisë dhe Kuvendit për të siguruar pavarësinë institucionale dhe buxhetore të Gjykatës	Sekretari i Përgjithshëm/Kabineti/ Njësia e Shërbimit Ligjor	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Përqindja e iniciativave ligjore në të cilat Gjykata merr pjesë
1.4.2	Organizimi i tryezave me grupe të ndryshme interesi me qëllim rritjen e bashkëpunimit institucional për çështje të përbashkëta	Sekretari i Përgjithshëm/Kabineti/ DMPJ	Në vazhdimësi	3,600.00 EUR ose 443,772 ALL	BGJ/Donatorë	Një tryezë e organizuar në vit
1.4.3	Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese të shteteve të tjera	Mbledhja e Gjyqtarëve	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ/Donatorë	Numri i marrëveshjeve me Gjykatat Kushtetuese të shteteve tjera të nënshkruara
1.4.4	Organizimi i konferencave ndërkombëtare në kuadër të 30-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese dhe 25 vjetorit të Kushtetutës.	Sekretari i Përgjithshëm/DMPJ	2022 dhe 2023	160,000.00 EUR ose 19,723,200 ALL	BGJ/Donatorë	2 konferenca të organizuara

1.4.5	Pjesëmarrja e gjyqtarëve në vizita studimore dhe veprimtari ndërkombëtare të organizuara nga gjykatat kushtetuese të huaja ose institucione të tjera.	Sekretari i Përgjithshëm/D MPJ	Në vazhdimësi	120,000 EUR ose 14,792,400 ALL	BGJ/Donatorë	1-2 vizita studimore të organizuara në vit Pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare sipas ftesave dhe kalendarit vjetor të parashikuar
1.4.6	Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias përmes kërkesave Amicus Curiae dhe kërkesave të paraqitura në Forumin e Komisionit të Venecias	Nëpunësi ndërlidhës	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i kërkesave dhe përgjigjeve në Forumin e Komisionit të Venecias dhe kërkesave Amicus Curiae
1.4.7	Bashkëpunimi me Rrjetin e Gjykatave Supreme të GJEDNJ-së	Nëpunësi i autorizuar	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i kërkesave dhe përgjigjeve në Rrjetin e Gjykatave Supreme të GJEDNJ-së, si dhe numri i përmbledhjeve të vendimeve të GJEDNJ-së që janë shpërndarë në Gjykatë

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

II. Forcimi i besimit të Gjykata përmes komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut e medias dhe promovimit të veprimtarisë së Gjykatës

2.1	Objektivi Specifik	Treguesit
		1. Publikimi i menjëhershëm i njoftimeve për kategori të veçanta të vendimeve.

Rritja e transparencës së veprimtarisë së Gjykatës, përmirësimi i komunikimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut						
		2. Publikimi i të gjitha vendimeve të marra nga Gjykata.				
		3. Aktivitetet, Buletini, fjalimet, publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës.				
		4. Të gjitha punimet shkencore të prezantuara nga gjyqtarët në konferenca shkencore publikohen.				
		5. Përqindja e kërkesave të miratuara për akses në dokumente publike që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës, në baza vjetore.				
		6. Përqindja e rritjes së besueshmërisë së publikut të Gjykata Kushtetuese.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efekt i Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e monitorimit
2.1.1.	Hartimi i planit të detajuar për komunikimin me publikun	DMPJ	T2 2021	11,800.00 EUR ose 1,454,586 ALL	BGJ/Donatorë	Strategjia për komunikimin me publikun, e miratuar

2.1.2.	Hartimi dhe miratimi i rregullave për marrëdhënien me publikun dhe median	Mbledhja e Gjyqtarëve/ DMPJ	T2 2021	5,900.00 EUR ose 727,293 ALL	BGJ/Donatorë	Rregullat për marrëdhënien me publikun dhe median të miratuara
2.1.3.	Zbatimi i Programit të Transparencës	Koordinatori për të drejtën e informimit	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Programi i Transparencës i përmirësuar dhe përditësuar
2.1.4	Përgatitja e broshurave informuese/promovuese për të drejtat e njeriut dhe funksionimin e Gjykatës	DMPJ	Çdo dy vite	2,000.00 EUR ose 246,540 ALL	BGJ/Donatorë	Numri i broshurave
2.1.5	Publikimi i menjëhershëm i njoftimeve për kategori të veçanta të vendimeve	DGJD/DMPJ	Në Vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Njoftimet e menjëhershme për kategoritë e veçanta të vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës
2.1.6	Krijimi dhe përditësimi i të dhënave në llogaritë e Gjykatës në rrjetet sociale (psh Twitter, Facebook etj) për të promovuar punën e Gjykatës. Krijimi i mundësisë të regjistrimit (abonimit) përmes regjistrimit të e-mailit dhe njoftimi automatik për zhvillimet në Gjykatë dhe për vendimet e marra dhe të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës	DMPJ/DGJD	T2 2021 T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ/Donatorë	Informacionet e publikuara në rrjetet sociale Të gjithë të regjistruarit (abonuarit) në faqen zyrtare marrin informacionet për të cilat janë regjistruar
2.1.7	Rishikimi i faqes zyrtare të Gjykatës për të mundësuar kërkimin e vendimeve sipas datës, kërkuesit, llojit të vendimit, natyrës së çështjes, shkeljes së pretenduar/gjetur, si dhe fjalë kyçe	Njësia e Shërbimit Ligjor/DGJD	T4 2021	10,000.00 EUR ose 1,232,700 ALL	Donatorë	Publikimi në faqen zyrtare i vendimeve duke përfshirë sistemin e avancuar të kërkimit të vendimeve

2.1.8	Dizenjimi dhe publikimi i buletinit elektronik periodik të Gjykatës	Sekretari i Përgjithshëm	Çdo 6 muaj	2,500.00 EUR ose 308,175 ALL	BGJ	Buletini i Gjykatës si dhe fjalimet etj
2.1.9	Publikimi i raportit vjetor për veprimtarinë e Gjykatës Publikimi i raportit për 30-vjetorin e Gjykatës	Sekretari i Përgjithshëm/Kabineti	Çdo vit 2022	Pa kosto shtesë	BGJ	Raporti vjetor i publikuar Raporti i publikuar
2.1.10	Organizimi i ditës së hapur për publikun	Sekretari i Përgjithshëm/Kabineti	Çdo vit	Pa kosto shtesë	BGJ	Organizimi i veprimtarive në kuadër të ditës së hapur për publikun
2.1.11	Publikimi i punimeve shkencore të prezantuara nga gjyqtarët në konferenca shkencore	DMPJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Punimet shkencore të publikuara
2.2	Objektivi Specifik	Treguesit				
Komunikimi me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe aktorët e tjerë që veprojnë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut		1. Rritja vjetore e përqindjes së kërkesave që kanë kaluar për shqyrtim në seancë plenare, si rezultat i aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese, me qëllim të informimit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën.				
	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efektet Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit

2.2.1	Organizimi i tryezave të përbashkëta me subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën si: Gjykata e Lartë, Avokati i Popullit, komisionerët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, etj.	Sekretari i Përgjithshëm/ DMPJ	Nje herë në 2 vite	Kosto në 1.4.1	BGJ/Donatorë	Numri i tryezave të organizuara
2.2.2	Organizimi i tryezave të përbashkëta me shoqatat e avokatëve	Sekretari i Përgjithshëm/ DMPJ	Një herë në 2 vite	2,700.00 EUR ose 332,829 ALL	BGJ/Donatorë	Numri i tryezave të organizuara
2.2.3	Kontributi përmes pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe këshilltarëve në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe leksioneve të hapura në universitete	Gjyqtarët/ Njësia e Shërbimit Ligjor	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Pjesëmarrja në aktivitete
2.3	Objektivi Specifik	Treguesit				
Forcimi i komunikimit me median		1. Numri njoftimeve të dhëna për median, në baza vjetore.				
		2. Numri i konferencave për median të mbajtuara nga Gjykata, në baza vjetore.				
		3. Numri i përgjigjeve për kërkesat që bën media për Gjykatën, në baza vjetore.				
		4. Numri i lajmeve për vendimet e Gjykatës të publikuara dhe transmetuara në medie, në baza vjetore.				

Nr	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efeksi Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
2.3.1.	Hartimi dhe miratimi i rregullave për marrëdhënien me publikun dhe medien (përsëritet me aktivitetin 2.1.2)	Mbledhja e Gjyqtarëve/ DMPJ	T2 2021	Kosto në 2.1.2	BGJ/Donatorë	Rregullat për marrëdhëniet me publikun dhe medien të miratuara
2.3.2.	Njoftimi i medias për datën dhe orën e mbajtjes së seancave plenare publike (me dyer të hapura)	DMPJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Njoftimet e medias
2.3.3.	Krijimi i mundësisë së transmetimit drejtpërdrejt (livestream) të seancave plenare publike përmes faqes zyrtare (ku përfshihet ndërtimi i sistemit për organizimin e seancave publike (software, hardware, kamerat dhe pajisjet e tjera të zërit, si dhe regjistrimi i seancave)). Këto masa lidhen edhe me objektin strategjik 2.1.	DGJD/DMPJ	T4 2021	35,000.00 EUR ose 4,314,450 ALL	BGJ/Donatorë	Sistemi i regjistrimit të seancave plenare audio dhe video, funksional.
2.3.4.	Krijimi i sistemit të akreditimit të gazetarëve dhe organizimi i trajnimeve bazë për juridiksionin dhe funksionimin e Gjykatës	Sekretari i Përgjithshëm/ Kabineti/ DMPJ	T4 2021	3,950.00 EUR ose 486,916 ALL	BGJ	Lista e gazetarëve të akredituar dhe të trajnuar
2.3.5.	Mbajtja e konferencave për median në periudha vjetore	Kryetari/ DMPJ	Nje herë në vit	Pa kosto shtesë	BGJ	Konferencat për medie të mbajtuara
2.3.6.	Kthimi i përgjigjeve në mënyrë të rregullt për çëshjet në interes të publikut dhe medias	DMPJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Përgjigjet e dhëna
2.3.7.	Pjesëmarrja në aktivitetet trajnuese për komunikimin me publikun dhe medien	DMPJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Pjesëmarrja në aktivtete trajnuese

2.3.8.	Organizimi i trajnimeve për stafin e Gjykatës për komunikimin me publikun në fushën e gjyqimit kushtetues	DMPJ	Një herë në vit	13,800.00 EUR ose 1,701,126 ALL	BGJ	Një trajnim në vit
III.	OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimi i integritetit, organizimit institucional dhe ngritja e kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese					
3.1	Objektivi Specifik	Treguesit				
	Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Gjykatës, i cili siguron koherencë dhe efikasitet të funksioneve brenda saj	1. Të gjitha njësitë organizative i kanë përgjegjësitë e përcaktuara qartë.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efeki Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
3.1.2	Përcaktimi i strukturës organizative të Gjykatës që reflekton përcaktimin e rolit dhe kompetencave të njësisve organizative	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Struktura organizative e miratuar
3.1.1	Miratimi i Rregullores së brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Rregullorja e brendshme e miratuar
3.2	Objektivi Specifik	Treguesit				
		1. Të gjithë nëpunësit e kanë të përcaktuar përshkrimin e vendit të punës.				

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe forcimi i integritetit në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës.		2. Të gjithë nëpunësit dhe këshilltarët ligjorë të vlerësuar në mënyrë periodike.				
		Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor
3.2.1	Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për staf bazuar në ngarkesën e punës, si dhe shpërndarja proporcionale e nëpunësve bazuar në këtë vlerësim	Mbledhja e Gjyqtarëve	T2 2022	Pa kosto shtesë	BGJ	Raporti i vlerësimit i draftuar
3.2.2	Draftimi i planit afatmesëm të personelit bazuar në riorganizimin e stafit brenda njësisë organizative	Mbledhja e Gjyqtarëve/ DEBNJ	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Plani afatmesëm i rekrutimit i miratuar
3.2.3	Miratimi i Rregullores së brendshme për rekrutimin, sistemin disiplinor të nëpunësve, përshkrimin e vendeve të punës, që reflekton, mes të tjerash, ndarjen e përgjegjësive brenda njësisë organizative të Gjykatës.	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2021	5,900.00 EUR ose 727,293 ALL	BGJ	Rregullorja e brendshme e miratuar
3.2.4	Miratimi i i Kodit të Etikës, duke përfshirë integritetin institucional dhe profesional	Mbledhja e Gjyqtarëve	T3 2023	5,900.00 EUR ose 727,293 ALL	BGJ	Kodi Etik, i miratuar

3.2.5	Përditësimi i përshkrimeve të vendeve të punës dhe përmirësimi i sistemit të vlerësimit të nëpunësve	Mbledhja e Gjyqtarëve/ DEBNJ	T4 2021	7,500.00 EUR ose 924,525 ALL	BGJ	Rregullorja e brendshme/përshkrimi i vendeve të punës dhe sistemi i vlerësimit, të miratuara
3.2.6	Krijimi i sistemit të vlerësimit të këshilltarëve ligjorë dhe zbatimi i tij	Mbledhja e Gjyqtarëve	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i këshilltarëve të vlerësuar
3.2.7	Zhvillimi i sistemit elektronik të menaxhimit të burimeve njerëzore	DEBNJ	T4 2022	7,000.00 EUR ose 862,890 ALL	BGJ	Sistemi elektronik i burimeve njerëzore
3.3	Objektivi Specifik	Treguesit				
Plotësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve për realizimin e përgjegjësisë të Gjykatës		1. Numri i vendeve vakante të plotësuara.				
		2. Numri i stafit në njësitë organizative që lidhen me funksionin e Gjykatës.				
		3. I gjithë stafi i ri i trajnuar.				
		4. Numri i stafit që merr pjesë në trajnime, vizita studimore, konferenca e programe shkëmbimi, në baza vjetore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit

3.3.1	Plotësimi i vendeve vakante	DEBNJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Të gjitha vendet e punës të planifikuara të plotësuara
3.3.2	Rishikimi i numrit të këshilltarëve ligjorë	Mbledhja e Gjyqtarëve/ DEBNJ	T1 2022	90,000.00 EUR ose 11,094,300 ALL	BGJ	Plotësimi i numrit sipas strukturës së miratuar së Njësisë së Shërbimit Ligjor
3.3.3	Draftimi i planit vjetor të trajnimeve	DEBNJ	2021-2023/muaji janar i çdo viti	Pa kosto shtesë	BGJ	Plani afatmesëm i trajnimeve i draftuar
3.3.4	Organizimi i trajnimeve për nëpunësit e rinj	DEBNJ/DMPJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Programi i trajnimeve i miratuar
IV.	OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: Planifikimi dhe koordinimi me efikasitet i burimeve financiare, përfshirë projektet e financuara nga partnerët ndërkombëtarë, menaxhimi i riskut dhe sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës					
4.1	Objektivi Specifik	Treguesit				
		1. Përqindja e buxhetit të miratuar të Gjykatës e shpenzuar brenda vitit.				
		2. Përqindja e rritur e buxhetit vjetor.				

Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të menaxhimit efikas të burimeve financiare në funksion të realizimit të objektivave të Gjykatës.		3. Institucionet tjera me rëndësi (Qeveria, Kuvendi) të sensibilizuara për pavarësinë buxhetore dhe nevojat buxhetore të Gjykatës.				
		4. Të gjitha njësitë organizative të Gjykatës të përfshira në planifikimin e nevojave buxhetore.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efektet Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
4.1.1	Identifikimi i nevojave buxhetore të Gjykatës në planin afatmesëm dhe draftimi i planit për kërkesat buxhetore	DEBNJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Plani për nevoja dhe arsyetimi i kërkesave buxhetore i draftuar
4.1.2	Nëpunësit përgjegjës për planifikimin e buxhetit ndjekin trajnime për planifikim të efektit buxhetor	DEBNJ	Një herë në vit	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i trajnimeve të ndjekura
4.1.3	Pjesëmarrja proaktive në planifikimin afatmesëm dhe vjetor të buxhetit të shtetit në procedurat para Qeverisë dhe organeve të Kuvendit	Sekretari i Përgjithshëm/D EBNJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i pjesëmarrjes në takimet me Qeverinë dhe Kuvendin
4.1.4	Organizimi i konferencave për pavarësinë e Gjykatës me theks në pavarësinë buxhetore të Gjykatës sipas Kushtetutës dhe ligjit organik	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Sekretari i Përgjithshëm	Një herë në dy vite	2,400.00 EUR ose 295,848 ALL	BGJ/Donatorë	Konferenca e organizuar dhe të zhvilluara
4.1.5	Organizimi i takimeve bilaterale me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, si dhe me Kuvendin gjatë procesit të planifikimit buxhetor për të paraqitur nevojat e Gjykatës për rritje të buxhetit.	Sekretari i Përgjithshëm/ Kabineti/ DEBNJ	Në vazhdimësi	Pa kosto shtesë	BGJ	Takimet e mbajtura
4.1.6	Miratimi dhe zbatimi për herë të parë i tarifave gjyqësore për palët në proces	Mbledhja e Gjyqtarëve	T3 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Tarifat e miratuara dhe zbatuara

4.2	Objektivi Specifik	Treguesit				
Forcimi i koordinimit me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët për të mbështetur arritjen e objektivave të Gjykatës		1. Numri i projekteve të financuara nga donatorët.				
		2. Numri i aktiviteteve të financuara nga donatorët, në të cilat Gjykata merr pjesë.				
		3. Përqindja e shumës së projekteve të financuara nga donatorët në raport me buxhetin e Gjykatës.				
Nr.	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efekti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
4.2.1.	Identifikimi i nevojave për mbështetje financiare nga donatorët për zbatimin e planit të Strategjisë së Gjykatës Kushtetuese	Sekretari i Përgjithshëm/ DEBNJ	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ	Raporti i nevojave për mbështetje financiare i draftuar
4.2.2	Organizimi i tryezave me donatorët, prezantimi i nevojave për mbështetje të projekteve të mundshme tek donatorët e mundshëm si OSBE, Zyra e BE (IPA), Këshilli i Evropës, USAID, GIZ, etj. Zbatimi i memorandumit me OSBE Propozimi i projekteve për mbështetje të mundshme nga donatorë, mes tjerash, për ofrim të trajnimeve, mbështetje të programeve të vizitave studimore dhe shkëmbimeve, si dhe për financimin e pajisjeve të teknologjisë informative	Mbledhja e Gjyqtarëve/ Sekretari i Përgjithshëm	T2 2021	1,000.00 EUR ose 123,270 ALL	BGJ	Projektet për mbështetje sipas nevojave të identifikuara, të draftuara. Mbështetja dhe financimi i projekteve të Gjykatës, të siguruar.
4.3	Objektivi Specifik	Treguesit				

Menaxhimi efikas i riskut për Gjykatën		1. Numri i risqeve të ndodhura.				
		2. Numri i objektivave të Strategjisë për Menaxhimin e Riskut, të plotësuar.				
	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit
4.3.1	Rishikimi i Strategjisë për Menaxhimin e Riskut 2018-2020	DEBNJ	T4 2021	Pa kosto shtesë	BGJ/Donatorë	Drafti i rishikuar i Strategjisë për Menaxhimin e Riskut
4.3.2	Zbatimi i Strategjisë për Menaxhimin e Riskut të rishikuar	DEBNJ	Në vazhdimësi nga T1 2022	Pa kosto shtesë	BGJ	Numri i masave të zbatuara sipas Strategjisë për Menaxhimin e Riskut
4.4	Objektivi Specifik	Treguesit				
Sigurimi i kushteve fizike për funksionimin e Gjykatës		1. Hapësirat e mjaftueshme të punës, të siguruara.				
		2. Mjetet e nevojshme të punës, të siguruara.				
	Masat Konkrete	Struktura përgjegjëse	Afati i zbatimit	Efkti Buxhetor	Burimi i financimit	Produkti (Output)/Treguesit e Monitorimit

4.4.1.	Draftimi i një plani të nevojave për ambiente pune me opsionet e mundshme dhe planifikimi i efekteve buxhetore	Sekretari i Përgjithshëm/D EBNJ	T2 2022	Pa kosto shtesë	BGJ	Plani i nevojave i draftuar
4.4.2	Ndërtimi i godinës së re për Gjykatën ose rinovimi i godinës aktuale	Mbledhja e Gjyqtarëve/Sekretari i Përgjithshëm/D EBNJ	T4 2023	1,500,000.00 ose 140,000.00 EUR ose 184,905,000 ose 17,257,800 ALL	BGJ/Nonatorë	Projekti për ndërtimin/rinovimin e godinës Godina e ndërtuar ose hapësirat ekzistuese të rinovuara
4.4.3	Identifikimi dhe sigurimi i mjeteve bashkëkohore të punës për stafin e Gjykatës	Sekretari i Përgjithshëm/D EBNJ	Në vazhdimësi	30,000.00 EUR ose 3,698,100 ALL	BGJ	Plani i nevojave i draftuar dhe efekti buxhetor i miratuar

